



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 561 Akti

Nr. 637 Vendimi
Tiranë, më 17.3.2023

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Valbona Sanxhaktari	Kryesuese
Lulzim Hamitaj	Relator
Genta Tafa (Bungo)	Anëtare

asistuar nga sekretarja gjyqësore, znj. Ertugena Sokoli, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Steven Kessler, në datat 10.3.2023 dhe 17.3.2023, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim mbi bazë dokumentesh çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z. Kasem Berberi**, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

Neni 179/b dhe nenet A, Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”.

Ligji nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatorit të çështjes, subjektin e rivlerësimit, vëzhguesin ndërkombëtar, si dhe pasi shqyrtoi dhe diskutoi mbi tërësinë e çështjes që i përket rivlerësimit kalimtar të subjektit të rivlerësimit Kasem Berberi, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, i cili në seancën dëgjimore publike të datës 10.3.2023, kërkoi konfirmimin në detyrë,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Subjekti i rivlerësimit Kasem Berberi, gjatë periudhës së fillimit të procesit të hetimit administrativ ka ushtruar detyrën e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Për shkak të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të prokurorëve dhe gjyqtarëve në Republikën e Shqipërisë”, ky subjekt i është nënshtruar procesit të rivlerësimit *ex officio*, në bazë të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

2. Subjekti i rivlerësimit Kasem Berberi i është nënshtruar procedurave të rivlerësimit, duke u shortuar si subjekt në shortin e hedhur, në datën 15.6.2020, nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, në përputhje me “Rregulloren për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”.

3. Trupi gjykues, me vendimin nr. 1, datë 22.6.2020, vendosi të fillojë një hetim administrativ të thellë dhe të gjithanshëm, sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, si dhe të caktojë kryesuese të trupit gjykues komisioneren Valbona Sanxhaktari, pasi të gjithë anëtarët deklaruan mospasjen e konfliktit të interesit. Nga ana e relatorit të çështjes janë ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në nenin 14, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

4. Në zbatim të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, nga subjekti i rivlerësimit Kasem Berberi janë nisur procedurat e rivlerësimit, si vijojnë:

a) plotësimi dhe dërgimi i deklaratës së pasurisë, sipas shtojcës 2 të ligjit nr. 84/2016, pranë ILDKPKI-së, brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016, sipas nenit 31;

b) plotësimi dhe dërgimi i deklaratës për kontrollin e figurës, sipas shtojcës 3 të ligjit nr. 84/2016, pranë DSIK-së, brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016, sipas nenit 35;

c) plotësimi dhe dërgimi i formularit të vetëvlerësimit profesional, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, pranë organit të vlerësimit të aftësive profesionale, brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi, sipas nenit 41 të ligjit nr. 84/2016.

5. Gjatë hetimit administrativ, konkretisht, në datat 21.7.2020 dhe 28.9.2022, u njoftua subjekti i rivlerësimit për përbërjen e trupit gjykues, duke i kërkuar gjithashtu të shprehej lidhur me ekzistencën e konfliktit të interesit me anëtarët e tij. Subjekti i rivlerësimit me anë të postës elektronike të datës 28.9.2022 konfirmoi mospasjen e ndonjë konflikti interesi me të tre anëtarët e trupit gjykues.

6. Pas përfundimit të fazës hetimore mbi rivlerësimin e subjektit të rivlerësimit Kasem Berberi, me vendimin nr. 2, datë 21.2.2023, trupi gjykues vendosi të mbyllë hetimet dhe në bazë të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016 vlerësoi që procesi i rivlerësimit për këtë subjekt të bazohet në të tria kriteret e rivlerësimit të parashikuara nga ligji nr. 84/2016.

7. Në datën 22.2.2023, Komisioni e njoftoi subjektin e rivlerësimit nëpërmjet postës elektronike mbi rezultatet e hetimit kryesisht dhe e ftoi atë për t'u njohur me dosjen dhe me provat e administruara prej tij, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016 dhe me nenet 35 - 40 dhe 45 - 47 të Kodit të Procedurave Administrative, si dhe për të paraqitur shpjegimet dhe për të provuar të kundërtën e rezultateve të kristalizuara në fund të hetimit administrativ, duke i dhënë kohë deri më 6.3.2023.

8. Subjekti i rivlerësimit, në datën 24.2.2023, u paraqit për t'u njohur me dokumentacionin e dosjes së hetimit administrativ dhe për tërheqjen e dokumentacionit përkatës në formë elektronike, të cilat iu vunë në dispozicion së bashku me rezultatet e hetimit kryesisht.

9. Trupi gjykues, pasi shqyrtoi shpjegimet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit në datën 6.3.2023, nëpërmjet vendimit nr. 3, datë 7.3.2023, vendosi caktimin e seancës dëgjimore në datën 10.3.2023, duke njoftuar subjektin përmes postës elektronike për këtë vendimmarrje.

II. SEANCA DËGJIMORE

10. Seanca dëgjimore u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, në datën 10.3.2023, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Steven Kessler.

11. Në vijim, pasi dëgjoji relatimin, subjekti i rivlerësimit Kasem Berberi parashtroi shpjegimet përkatëse lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht, si dhe mbi procesin e rivlerësimit të kryer ndaj tij, duke iu referuar edhe shpjegimeve të paraqitura më herët me shkrim. Në fund të seancës dëgjimore subjekti i rivlerësimit kërkoi konfirmimin në detyrë. Seanca dëgjimore e datës 10.3.2023 u mbyll, për të rifilluar, sipas vendimit nr. 4, datë 13.3.2023, në datën 17.3.2023 për shpalljen e vendimit, ku sërish ishte prezent edhe subjekti.

III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

12. Subjekti i rivlerësimit ka qenë bashkëpunues në procesin e rivlerësimit, duke u përgjigjur në kohë, kur i është kërkuar – sipas parashikimeve të nenit 48 të ligjit nr. 84/2016 – përgjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ.

IV. HETIMI ADMINISTRATIV I KRYER NGA KOMISIONI

13. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu një hetim dhe vlerësim të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (i) provat e dorëzuara nga subjekti i rivlerësimit pranë ILDKPKI-së në deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar *Vetting*; (ii) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; (iii) raportin mbi kontrollin e figurës të dorëzuar në Komision nga DSIK-ja; (iv) provat shkresore/dokumentet e administruara nga organet publike dhe private në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (v) raportin e përpiluar nga KLP-ja; (vi) deklaratimet dhe përgjigjet e subjektit të

rivlerësimin të bëra me anë të komunikimit elektronik; (vii) shpjegimet me shkrim dhe dokumentacionin mbështetës të paraqitur nga subjekti i rivlerësimin pas njoftimit të mbylljes së hetimit administrativ; (viii) argumentet e paraqitura në seancë dëgjimore; si dhe (ix) faktet e njohura botërisht.

A. VLERËSIMI I PASURISË

A/1. VLERËSIMI I PASURISË NGA ILDKPKI-ja

14. Bazuar në nenet 30 - 33 të ligjit nr. 84/2016, ILDKPKI-ja ka dërguar në Komision raportin lidhur me deklaratimet dhe vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimin, duke konstatuar se:

- *deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesit.*

15. Komisioni ka hetuar në mënyrë të pavarur mbi çdo informacion dhe konkluzion të institucionit të lartpërmendur, ashtu sikurse mbi të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016.

16. Hetimi administrativ në lidhje me vlerësimin e pasurisë ka konsistuar në: verifikimin e vërtetësisë së deklaratimeve në lidhje me gjendjen pasurore të subjektit dhe personave të lidhur; verifikimin e burimeve të krijimit të të ardhurave dhe shpenzimeve, me qëllim evidentimin e mungesës së mundshme të burimeve të mjaftueshme financiare për të justifikuar pasuritë; evidentimin e ndonjë fshehjeje të mundshme të sendeve në pronësi ose përdorim; evidentimin e ekzistencës së mundshme të deklaratimeve të rreme apo të ndonjë konflikti të interesave, të parashikuara nga pika 5 e nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

A/2. RIVLERËSIMI I PASURISË NGA KOMISIONI

1. Apartament në rrugën “**”, Tiranë**

1. Kjo pasuri është deklaruar nga subjekti i rivlerësimin në DIPP-në e vitit 2003 dhe në deklaratën *Vetting* si pasuri e llojit apartament me sip. 105 m², e ndodhur në rrugën “****”, Tiranë. Ky apartament është përfituar nëpërmjet nënshkrimit të kontratës së shitblerjes¹ datë 21.4.2000 me palën shitëse “*****” sh.p.k. kundrejt çmimit total 5.000.000 lekë. Burimi i krijimit të kësaj pasurie është deklaruar kredia bankare² pranë ish Bankës së Kursimeve, kredi që vijon ende të shlyhet.
2. “Raiffeisen Bank”, me shkresën nr. *** prot., datë 15.9.2020, vuri në dispozicion dokumentacionin e subjektit për përfitimin e kredisë për strehim sipas përcaktimeve në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 102, datë 5.3.1999 “Për trajtimin me strehim të funksionarëve politikë dhe nëpunësve civilë të administratës së lartë shtetërore” dhe kontratën e huas të nënshkruar në vitin 2000 me ish Bankën e Kursimeve.

¹ Kontratë me kusht kreditimi nr. ****, datë 21.4.2000.

² Përfituar kredi për strehim në përputhje me përcaktimet ligjore të VKM-së Nr. 102, datë 5.3.1999.

3. Në datën 2.6.2000, ndërmjet z. Kasem Berberi dhe ish Bankës së Kursimeve është nënshkruar kontrata e huas dhe nëpërmjet urdhërshirimit datë 2.6.2000 është transferuar shuma e kredisë prej 5.000.000 lekësh nga z. Kasem Berberi në favor të palës shitëse, shoqërisë “****” sh.p.k.
4. ASHK Tirana Veri³, sipas përgjigjes së saj, konfirmoi regjistrimin e pasurisë të llojit apartament, nr. pasurie ****, të ndodhur në z. k. ****, në emër të subjektit, ku në kartelën e pasurisë në seksionin E të hipotekave pasuria vijon ende të jetë e bllokuar në favor të bankës.
5. UKT-ja⁴ nuk konfirmoi kontratë në emër të subjektit, ndërsa FSHU-ja⁵ informoi se në emër të shtetasit Kasem Berberi, në qytetin e Tiranës, rezultoi një kontratë furnizimi me adresë në rrugën “*****”, Tiranë, regjistruar në datën 23.3.2001, adresë që përputhet me atë të apartamentit të lartpërmendur.
6. Nga hetimi administrativ për këtë pasuri Komisioni arrin në përfundimin se nuk konstatohen problematika lidhur me përfitimin, deklarimin apo ligjshmërinë e burimeve të krijimit, për sa kohë burimi i krijimit të kësaj pasurie rrjedh totalisht nga kredia për strehim, akorduar sipas kushteve dhe kritereve të përcaktuara në VKM-në nr. 102, datë 5.3.1999 “Për trajtimin me strehim të funksionarëve politikë dhe nëpunësve civilë të administratës së lartë shtetërore”.

2. Apartament në ***, Durrës

7. Ky apartament është deklaruar në DIPP-në e vitit 2005 dhe në deklaratën *Vetting*, për të cilën midis subjektit dhe palës investitore “****” sh.p.k.⁶ është nënshkruar kontrata⁷ e sipërmarrjes datë 28.5.2005, me çmim 20.000 euro, paguar tërësisht në Bankën Amerikane të Shqipërisë në llogarinë e palës shitëse, ku si burim krijimi për blerjen e saj ka deklaruar kursimet familjare ndër vite.
8. Referuar DIPP-së së vitit 2004 subjekti ka deklaruar një depozitë bankare në “ProCredit Bank” në emër të bashkëshortes në shumën 1.000.000 lekë me burim krijimi nga pagat ndër vite dhe kursimet, ndërsa në DIPP-në e vitit 2005 ka deklaruar shtimin e saj me shumën 820.000 lekë. Nga shqyrtimi i dokumentacionit bankar të depozitës rezultoi se është tërhequr nga bashkëshortja e tij shuma 1.700.000 lekë, e cila ka shërbyer si burim për blerjen e apartamentit, ndërsa pjesa tjetër prej 800.000 lekësh është deklaruar me burim krijimi kursimet ndër vite të administruara në banesë.
9. “ProCredit Bank”⁸ në përgjigje të saj informoi se znj. L. B. nuk ka pasur llogari pranë kësaj banke dhe në deklaratimet në vijimësi llogaria bankare e bashkëshortes së subjektit ishte deklaruar në “Credins Bank”. Komisioni, për t’u qartësuar për sa më lart, iu drejtua⁹ “Credins Bank”¹⁰, e cila

³ Shkresë nr. *** prot., datë 18.9.2020.

⁴ Shkresë nr. *** prot., datë 24.8.2020.

⁵ Shkresë nr. *** prot., datë 13.8.2020.

⁶ Prokuroria e Përgjithshme, me shkresën nr. *** prot., datë 22.11.2022 dhe Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me shkresën nr. *** prot., datë 17.10.2022, informoi se për periudhën kohore 2015 – 2022 nuk rezultoi që ndaj shtetasve apo personave fizikë apo juridikë shoqëria “****” sh.p.k., shtetasit I. J. N./I, F. Gj., H. K., N. F., P. B., I. P., shoqëria “****”, shoqëria “****” sh.p.k., A. K., M. F., N. K., dhe A. V. të jenë regjistruar procedime penale të hetuara nga prokurori Kasem Berberi.

⁷ Kontrata nr. ***.

⁸ Shkresë nr. *** prot., datë 17.11.2022.

⁹ Shkresë nr. *** prot., datë 11.11.2022.

¹⁰ Shkresë nr. *** prot., datë 29.12.2022.

konfirmoi se bashkëshortja ka pasur llogari pranë saj dhe nuk zotëron llogari rrjedhëse individuale.

10. Për të provuar ekzistencën e depozitës bankare në emër të bashkëshortes, Komisioni i kërkoi subjektit të paraqiste dokumentacionin e llogarisë bankare në emër të saj. Në përgjigje të pyetësorit, subjekti paraqiti lëvizjet e llogarisë së pagës dhe të depozitës bankare pranë “Credins Bank” në emër të bashkëshortes, informacion që u konfirmua edhe me shkresën kthim përgjigjeje nga kjo bankë¹¹ datë 8.3.2023.
11. Lidhur me pasurinë e llogjit apartament të ndodhur në ***, Durrës, ASHK Durrës¹², kjo e fundit informoi se nga verifikimi i sistemit dixhital nuk rezultonte pasuri e regjistruar në emër të subjektit dhe familjarëve të tij. Po ashtu, Komisioni konstatoi se nga kontrolli në sistemin *online* multifunksional të ASHK-së në emër të shtetasit Kasem Berberi ekzistonte pasuri e regjistruar apartament, ndodhur në z. k. ***, nr. pasurie ***, me adresë “****”, Durrës.
12. Për sa më sipër, Komisioni i kërkoi subjektit të informonte lidhur me statusin juridik aktual të apartamentit, si dhe të vinte në dispozicion dokumentacionin ligjor të disponuar për këtë pasuri dhe ky i fundit paraqiti certifikatën për vërtetimin e pronësisë të regjistruar fillimisht në datën 10.2.2020, në emër të palës shitëse “****” sh.p.k., si dhe certifikatën e regjistrimit të pronës në emër të tij të lëshuar në datën 26.4.2022. Bashkëlidhur praktikës ai vuri në dispozicion kontratën e shitblerjes të nënshkruar në datën 22.4.2022 me palën shitëse “****” sh.p.k., nga ku konfirmohet se çmimi i blerjes prej 20.000 euro është paguar sipas kontratës së sipërmarrjes në vitin 2005.
13. Gjithashtu, Komisioni i kërkoi subjektit të jepte shpjegime lidhur me përdorimin e këtij apartamenti. Subjekti shpjegoi se apartamenti nuk është përdorur prej tij dhe as nuk ishte dhënë me qira, pasi ka pasur mungesë të vazhdueshme të ujit të pijshëm, por disa herë është përdorur nga të afërmit e tij.
14. Nisur nga dokumentacioni i administruar nga hetimi administrativ për këtë pasuri, Komisioni konstatoi se apartamenti ishte regjistruar fillimisht në emër të palës shitëse në muajin shkurt 2020, ndërkohë që rezulton të jetë regjistruar në emër të subjektit në muajin prill të vitit 2022. Nisur nga sa më sipër, Komisioni i kërkoi gjithashtu shpjegime mbi arsyet e transferimit të titullit të pronësisë në emër të tij, vetëm 2 vite pas regjistrimit fillestar.
15. Lidhur me ekzistencën e mundshme të konfliktit të interesit, Komisioni iu drejtua organit të Prokurorisë së Përgjithshme, e cila me shkresën nr. *** prot., datë 22.11.2022, bashkëlidhur shkresën nr. *** prot., datë 17.10.2022, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, informoi se për vitet 2015 – 2022 nuk rezultoi që ndaj shtetasve apo personave fizikë apo juridikë¹³ të përmendur në këtë shkresë të jenë regjistruar procedime penale.
16. Përveç sa është përshkruar më sipër, referuar informacionit të marrë nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë evidentohet se kjo e fundit informoi vetëm mbi ekzistencën si palë të mundshme, të shtetasve apo personave fizikë ose juridikë të përmendur në shkresë, por

¹¹Shkresë nr. *** prot.

¹²Shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 2.9.2020.

¹³Shoqëria “****” sh.p.k., shtetasit I. N./I. F. Gj., H. K., N. F., P. B., A. V., I. P., shoqëria “****” sh.p.k., shoqëria “****” sh.p.k., A.K., M. F., N. K.

nuk qartësoi mbi pjesëmarrjen e mundshme të shtetasit A. V.¹⁴ në cilësinë e avokatit, në ndonjërin prej çështjeve ku subjekti ka ushtruar funksionin e prokurorit.

17. Komisioni i kërkoi subjektit të rivlerësimit të jepte shpjegime mbi gjendje të mundshme të konfliktit të interesit me z. A. V., si dhe të bënte me dije nëse kishte hetuar/shqyrtuar çështje me palë të mbrojtura nga av. A. V., duke depozituar edhe dokumentacionin ligjor përkatës.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

18. Në shpjegimet dhe prapësimet e depozituara, për sa i takon regjistrimit të apartamentit në “****”, Durrës, subjekti shpjegoi se në momentin që ishte njoftuar nga pala shitëse për hipotekimin e apartamentit, ai ishte paraqitur menjëherë përpara noterit për të nënshkruar kontratën e shitblerjes.
19. Lidhur me gjendjen e mundshme të konfliktit të interesit me shtetasin A. V., në cilësinë e avokatit, në shpjegimet e paraqitura, ai shpjegoi se nuk i kujtohej asnjë rast që të ketë qenë përfaqësues apo mbrojtës në çështjet që ka pasur në hetim apo gjykim. Lidhur me pagesat e kryera në emër të këtij shtetasi subjekti sqaroi se në periudhat përgjatë viteve 2014 – 2015 dhe në një rast tjetër subjekti ka paguar në emër të z. A. V. këstet mujore të kredisë dhe se në të gjitha rastet shumat përkatëse i janë dhënë pas nga ky i fundit, duke depozituar një deklaratë noteriale¹⁵ të shtetasit në fjalë, nga ku konfirmohet sa më sipër.

Vlerësimi i trupit gjykues

20. Lidhur me regjistrimin e pasurisë në emër të subjektit të rivlerësimit, 2 vjet pas regjistrimit fillestar të saj në emër të palës shitëse, në kushtet kur subjekti nuk paraqiti ndonjë dokumentacion që të provonte njoftimin e tij nga pala shitëse për regjistrimin e pasurisë, trupi gjykues vlerëson se shpjegimet e subjektit mbeten në nivel deklarativ, ndonëse kjo rrethanë, në vetvete, nuk përbën ndonjë problematikë konkrete në raport me objektin e procesit të rivlerësimit.
21. Nisur nga sa është shpjeguar, por edhe nga dokumentacioni i disponuar nga institucionet, në raport me marrëdhënien miqësore për të cilën është pyetur, për aq kohë sa nuk u evidentua ndonjë rast ku subjekti i rivlerësimit të ketë hetuar apo shqyrtuar çështje me palë të interesuar shtetasin/av. A. V., Komisioni i vlerëson shpjegimet bindëse dhe shteruese, duke mos konstatuar ndonjë konflikt interesi.

2.1. Analiza financiare e burimit të krijimit të pasurisë

22. Subjekti i rivlerësimit për të provuar shlyerjen e plotë të shumës për blerjen e apartamentit palës shitëse vuri në dispozicion mandatarkëtimin e shumës prej 20.000 euro, datë 31.5.2005, të paguar në favor të palës shitëse “****” sh.p.k. pranë Bankës Amerikane të Shqipërisë, shumë kjo e konvertuar në vlerën 2.450.800 lekë.
23. Komisioni, nga analizimi i dokumentacionit bankar në “Credins Bank” të depozitës me vlerë 1.700.000 lekë, konstatoi se është krijuar me burim: (i) shumën 1.300.000 lekë, krijuar nga të ardhurat nga pagat e patërhequra të bashkëshortes; (ii) shumën 400.000 lekë, e depozituar *cash* nga bashkëshortja. Nga Komisioni kjo shumë u analizua si e krijuar me burim nga të ardhurat e

¹⁴ Subjekti ka paguar disa herë në emër të z. A. V. këstet e kredisë mujore të këtij të fundit dhe se shumat përkatëse të parave i janë dhënë nga ana e tij, duke paraqitur disa mandate bankare.

¹⁵ Deklarata noteriale nr. ***, datë 3.3.2023, e z. A. V.

vetë subjektit, për sa kohë bashkëshortja e tij nuk kishte tërhequr ndonjë vlerë nga llogaria e pagës deri në atë moment.

24. Ndërsa, për sa i takon diferencës së çmimit nga vlera totale e blerjes prej 750.800 lekësh¹⁶ ai shpjegoi se kjo diferencë ka pasur si burim krijimi kursimet e administruara prej tyre në banesë. Për sa i takon këtij pretendimi, Komisioni konstatoi se nga shqyrtimi i deklarimeve periodike të tij ndër vite, përveç deklarimit në DIPP-në e vitit 2003, nuk rezulton i deklaruar në vijim si shtesa apo pakësime, si dhe nuk ka deklaruar në vijimësi disponimin e ndonjë shume *cash* as në deklaratën *Vetting*.

Në vijim të hetimit administrativ, për sa i takon burimit të ligjshëm të këtyre të ardhurave të deklaruar në DIPP-në e vitit 2003 si të përdorura për mbulimin e diferencës së çmimit, Komisioni i kërkoi subjektit të paraqiste dokumentacionin ligjor që provonte burimin e ligjshëm të krijimit të tyre, si dhe të informonte mbi destinacionin e përdorimit të shumës 2.500.000 lekë, të deklaruar *cash* në DIPP-në e vitit 2003.

25. I pyetur nga Komisioni subjekti shpjegoi se kjo vlerë ka qenë krijuar më herët me burim nga të ardhurat e përfituara nga puna e tij si avokat në vitet 1992 – 1999, si dhe nga kursimet familjare nga paga, pasi përgjatë viteve 1993 – 1997 kishte punuar si jurist pranë shoqërisë “****” s.a.¹⁷ Gjirokastër, por për të vërtetuar punësimin nuk mund të paraqiste ndonjë dokumentacion të kohës, pasi ato ishin djegur gjatë trazirave.
26. Nisur nga fakti se për këto të ardhura nuk u arrit të provohej me anë të ndonjë dokumentacioni ligjor përfitimi i tyre, pagimi i detyrimeve tatimore apo të provohej pamundësia për të paraqitur dokumentacionin provues, Komisioni nuk i konsideroi këto të ardhura në analizën financiare të blerjes së kësaj pasurie.
27. Fillimisht, për të provuar mundësinë e krijimit të kursimeve në formën *cash*, me burime të ligjshme financiare deri në fund të vitit 2003, Komisioni analizoi të ardhurat e subjektit dhe të bashkëshortes së tij për periudhën 1999¹⁸ – 2003, të cilat rezultuan në masën 6.806.592 lekë, po ashtu, përllogaritë shpenzimet e familjes përgjatë të njëjtës periudhë, duke përfshirë këtu edhe investimet e kryera prej tyre në pasuri të paluajtshme, si dhe kursimet të tyre nëpër llogaritë bankare apo në formën *cash*.
28. Në përfundim të analizës financiare për këtë pasuri, Komisioni konstatoi se subjekti ka pasur mjaftueshmëri të burimeve financiare të ligjshme për të mbuluar shpenzimet familjare dhe për të krijuar kursimet e pretenduara prej 2.500.000 lekësh në formën *cash*, sipas detajimit në tabelën e mëposhtme.

¹⁶ Midis çmimit të blerjes prej 2.450.800 lekësh dhe shumës së tërhequr nga depozita e mësipërme prej 1.700.000 lekësh.

¹⁷ Në mars të vitit 1997 magazinat e kësaj shoqërie janë vjedhur për shkak të trazirave.

¹⁸ Subjekti është punësuar në Prokurorinë e Përgjithshme datë 21.7.1999, bashkëshortja punësuar në “****” sh.a., datë 1.11.1999.

Tabela nr. 1 – Analiza financiare për periudhën 1999 – 2003

Te ardhura nga pagat e subjektit 1999 - 2003	4,885,420
Te ardhura nga pagat e b/shortes 1999 - 2003	1,921,172
Shpenzime jetese 1999 - 2003 (3 persona)	(1,335,563)
Shpenzime per arsimin e djalit 1999 - 2003	(315,000)
Shpenzime per mobilim	(250,000)
Blere apartament ne prill 2000	(5,000,000)
Kredi bankare prane Bankes se Kursimeve	5,000,000
Shpenzime kredie ne RZB (ish Banka Kursimeve)	(974,353)
Investuar ne depozite me afat nga b/shortja	(168,576)
Krijuar kursime ne cash deri ne fund te 2003	(2,500,000)
Rezultati në 31.12.2003	1,263,100

29. Lidhur me destinacionin e përdorimit të këtyre kursimeve të disponuara *cash* Komisioni iu drejtua sërish edhe në përgjigje të pyetësorit nr. 4, ku shpjegoi se gjendja *cash* është përdorur prej tyre ndër vite për shpenzime familjare, blerje të orendive të ndryshme shtëpiake, si dhe shpenzime të tjera, por se nuk mund të saktësojë se sa ka qenë vlera e shpenzuar për çdo vit për këto shpenzime nga gjendja e kursimeve të disponuara *cash* në banesë.
30. Në mungesë të të dhënave të plota bankare të llogarisë së pagës së subjektit¹⁹ për të gjithë periudhën e analizuar, nga ana e Komisionit u përllogaritën të ardhurat për periudhën janar - maj 2005, në mënyrë përpjesëtimore në raport me të ardhurat e vitit, nga ku rezultoi se ka pasur të ardhura në masën 681.381 lekë²⁰ nga të ardhurat vjetore, si dhe duke mbajtur në konsideratë faktin se ai ka deklaruar gjendje *cash*, e cila ka qenë gjithashtu gjendje e disponueshme në muajin maj të vitit 2005.
31. Nisur nga sa më sipër, Komisioni nuk mund të përjashtojë mundësinë e përdorimit të gjendjes *cash* për kryerjen e plotë të pagesës, por gjithsesi edhe në rastin e përdorimit do të rezultonte në pamundësi në fund të vitit për të ruajtur të njëjtën shumë *cash* të deklaruar në vitin 2003, duke rezultuar në një situatë negative -499.514 lekë. Nëse nuk e merret në konsideratë përdorimi eventual i gjendjes *cash*, rezulton një mungesë e burimeve të ligjshme financiare prej -725.189 lekësh²¹, shihni në tabelën në vijim.

Tabela nr. 2 – Analiza e burimeve për blerjen e apartamentit

Te ardhura nga pagat 1.1.2005 - 31.5.2005	681,381
Shpenzime jetese 1.1.2005 - 31.5.2005	(136,946)
Shpenzime kredie janar - maj 2005	(118,824)
Terhequr nga depozita e b/shortes	1,700,000
Depozituar nga b/shortja	(400,000)
Pagese e cmimit te apartamentit	(2,450,800)
Rezultati në datë 31.5.2005	(725,189)

¹⁹ Transferimi i pagës nëpërmjet sistemit bankar ka filluar në datën 31.3.2005.

²⁰ Të ardhurat nga pagat e bashkëshortes nuk janë përfshirë pasi ato nuk janë tërhequr.

²¹ Rezultati i analizës financiare të vitit 2005 rezultoi më i ulët, përkatësisht – 499.514 lekë, si pasojë e konsiderimit në të, të të gjitha të ardhurave dhe shpenzimeve të vitit 2005, ndërkohë që vlera prej – 725.189 lekësh i përket veç periudhës janar - maj 2005.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

32. Në shpjegimet e depozituara nga subjekti mbi rezultatet e hetimit administrativ lidhur me përdorimin e një pjese të gjendjes *cash* prej 2.500.000 lekësh, ai sqaroi se ashtu sikurse kishte shpjeguar edhe më herët, se për blerjen e apartamentit në Durrës nga ana e tij është përdorur edhe një pjesë e gjendjes *cash* që kanë pasur në banesë deri në fund të vitit 2003.

Vlerësimi i trupit gjykues

33. Pas analizimit të shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit, por edhe duke mbajtur në vëmendje çka u konstatua përgjatë hetimit administrativ, Komisioni arrin në përfundimin se rezultati i njoftuar subjektit për blerjen e apartamentit në qytetin e Durrësit për një pamundësi të burimeve financiare në shumën prej – 499.514 lekësh, mbetet i pandryshuar, pasi burimet alternative të cituara prej tij nuk kanë gjetur mbështetje në prova të dokumentuara, ndonëse përdorimi i pjesshëm i një gjendjeje *cash* nuk mund të përjashtohet. Megjithatë, Komisioni çmon se nisur nga vlera konkrete, kjo pamjaftueshmëri nuk passjellë pasoja për subjektin e rivlerësimit.
34. Komisioni, gjithsesi, lidhur me pasurinë në analizë arrin në përfundimin se deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e administruar nga hetimi administrativ dhe se nuk evidentohen problematika penalizuese për subjektin e rivlerësimit.

3. Apartament në rrugën “**”, në pronësi të djalit D. B., në Tiranë**

35. Apartamenti është deklaruar në DIPP-në e vitit 2015 dhe në deklaratën *Vetting* si pasuri e regjistruar në pronësi të djalit të subjektit, z. D. B. Kjo pasuri është përfituar nëpërmjet nënshkrimit të kontratës së shitblerjes²² datë 28.1.2015, lidhur mes djalit të subjektit dhe palës shitëse N. dhe M. F.²³, kundrejt çmimit total të likuiduar plotësisht prej 40.000 euro, sipas mandatit të datës 28.1.2015, në “Tirana Bank”. Nga dokumentacioni i administruar nga ASHK Tirana Veri²⁴ konfirmohet regjistrimi i apartamentit me nr. **** pasurie, në z. k. ***, në emër të shtetasit D. B., duke bashkëlidhur edhe dokumentacionin ligjor kontratë shitblerjeje²⁵ dhe certifikatë për vërtetimin e pronësisë.
36. Nga shqyrtimi i DIPP-së së vitit 2015 dhe deklaratës *Vetting* subjekti ka deklaruar si burim krijimi të shumës 40.000 euro që ka shërbyer për blerjen e apartamentit (në pronësi të djalit): (i) shumën 1.900.000 lekë, tërhequr nga depozita e djalit në “Credins Bank”; (ii) shumën 1.791.000 lekë tërhequr nga depozita e subjektit në “Credins Bank”; dhe (iii) shumën 2.000.000 lekë, marrë hua nga kunata E. Sh.
37. Nga analizimi i deklaratave periodike vjetore lidhur me huan e marrë shtetases E. Sh., Komisioni konstatoi se subjekti nuk ka deklaruar në rubrikën specifike të detyrimeve ndaj personave juridikë e fizikë të DIPP-ve të viteve 2015 dhe 2016 dhe as të deklaratës *Vetting*, ndonjë shumë të shlyer apo ndonjë detyrim të mbetur pa shlyer. Po ashtu, konstatoi se nuk kishte paraqitur ndonjë

²² RNSH-ja, me shkresën nr. *** .. datë 12.8.2020, konfirmoi nënshkrimin e kontratës së shitblerjes.

²³ Pasuria ishte blerë më herët nga shtetasi N. F. në vitin 2009, kundrejt vlerës 4.400.000 lekë nga shoqëria “****”.

²⁴ Shkresë nr. *** prot., datë 6.10.2022.

²⁵ Pasuria më parë ishte blerë në vitin 2009 nga familja F. kundrejt shumës 4.400.000 lekë.

dokumentacion ligjor të kohës që të provojë ekzistencën e marrëdhënies, mënyrën dhe kohën e dhënies së huas.

38. Në këto kushte, Komisioni i kërkoi subjektit të paraqiste dokumentacionin ligjor që provonte mënyrën e dhënies së huas, si dhe të ekzistencës së marrëdhënies juridike mes tyre. Ky i fundit, në përgjigje të pyetësorëve, shpjegoi se për shkak të marrëdhënies familjare ata nuk kishin përpiluar ndonjë dokument me shkrim apo kontratë huaje.
39. I pyetur nga Komisioni lidhur me arsyet e mosdeklarimit në asnjë prej deklaratave periodike vjetore të detyrimit/huas së pashlyer ndaj znj. E. Sh., subjekti shpjegoi se ende nuk e ka shlyer huan/detyrimin²⁶ dhe se mosdeklarimi nga ana e tij në rubrikën e detyrimeve në deklaratën *Vetting* ka qenë thjesht një harresë. Për të provuar sa më sipër, në përgjigje të pyetësorit ai depozitoi një deklaratë noteriale²⁷ të lëshuar nga kunata e tij E. Sh., e cila deklaroi se në muajin janar 2015 i kishte dhënë hua nipit të saj shumën 2.000.000 lekë për blerjen e një apartamenti në Tiranë.
40. Komisioni, referuar kontratës së shitblerjes së kësaj pasurie lidhur me çmimin e blerjes së apartamentit, bazuar në udhëzimin nr. 4, datë 30.9.2015 “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave për vitin 2015”, konstatoi se vlera mesatare e shitblerjes së banesave në tregun e lirë për vitin 2015 në zonën 2/2 të qytetit të Tiranës ka qenë 135.000 lekë/m², nga ku çmimi i shitjes së apartamentit do të rezultonte rreth 55.900 euro për një apartament me sipërfaqe 57 m².
41. Nisur nga sa më sipër, lidhur me këtë mospërputhje Komisioni i kërkoi subjektit të rivlerësimit të jepte shpjegime bindëse mbi arsyet e aplikimit të një çmimi më të ulët se çmimi i referencës së zonës për kohën, si dhe të depozitonte disa kontrata të ngjashme shitblerjeje për pasuri të ngjashme në të njëjtin pallat dhe në të njëjtën periudhë.
42. Lidhur me ekzistencën e ndonjë konflikti të interesit me palën shitëse N. dhe M. F., në përgjigje të shkresës së Komisionit, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë²⁸ informoi se nuk ka pasur ndonjë çështje penale të regjistruar në ngarkim të tyre.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

43. Subjekti i rivlerësimit nëpërmjet shpjegimeve dhe dokumentacionit të depozituar në prapësime ka bërë me dije se apartamenti në pronësi të djalit të tij ndodhet në zonën 2/3, ku vlera mesatare e shitblerjes në tregun e lirë për vitin 2016, sipas Entit Kombëtar të Banesave, ka qenë me çmim 95.000 lekë/m². Gjithashtu, ai depozitoi hartën treguese të zonave në Tiranë, një fotografim nga geoportali *asig.gov.al*. e, ndër të tjera, shpjegoi se apartamenti ka një sipërfaqe prej 57 m², nga e cila 14 m² e sipërfaqes së përgjithshme është ballkon, fakt ky që është marrë në konsideratë nga palët gjatë negociimit të vlerës së shitblerjes së pasurisë, duke paraqitur një kontratë shitblerjeje²⁹ të vitit 2014.

²⁶ Palët kanë rënë dakord që do të shlyhen në momentin që bashkëshortja do të përfitojë kompensimin nga trashëgimia.

²⁷ Shkresë nr. *** prot., të datës 28.1.2023.

²⁸ Shkresë nr. *** prot., datë 17.10.2022.

²⁹ Kontratë nr. ***, datë 19.2.2014, me sip. 105.2 m², me vlerë 11.046.000 lekë, çmimi/m², 105.000 lekë/m².

Vlerësimi i trupit gjykues

44. Trupi gjykues, pasi analizoi shpjegimet e subjektit dhe dokumentacionin e depozituar prej tij në prapësime, duke rikonsideruar zonën kadastrale dhe vlerësuar edhe informacionet e dokumentet e disponuara përgjatë hetimit administrativ, arriti në përfundimin se nuk ka pasur një trajtim preferencial apo favorizues. Gjithashtu, për sa kohë nuk u provua as ekzistenca e ndonjë konflikti interesi me palën shitëse, në mënyrë të tillë që të ngrinte dyshime mbi ndonjë trajtim favorizues, nëpërmjet aplikimit të ndonjë çmimi më të ulët se ai i tregut, në favor të subjektit të rivlerësimit, i gjen shpjegimet e subjektit të rivlerësimit bindëse.

3.1. Analiza financiare e burimeve për blerjen e apartamentit

3.1.1. Të ardhurat nga shitja e njësisë së shërbimit

45. Referuar deklaramentit mbi burimin e krijimit të kësaj pasurie ka rezultuar se nga shqyrtimi i lëvizjeve të llogarive bankare shumë 1.900.000 lekë dhe 1.791.000 lekë janë krijuar nga shitja e një pasurie të paluajtshme të llojit “njësi shërbimi” në pronësi të ndodhur në qytetin e Gjirokastrës.
46. Lidhur me këtë pasuri ASHK Gjirokastrë³⁰ konfirmoi se në emër të subjektit rezultoi e legalizuar njësi e shërbimit me sip. 44 m², ndërtuar si shtesë anësore e një pasurie të disponuar më herët prej tij e quajtur “punishte e pastave”. Komisioni konstatoi se në DIPP-në e vitit 2009 për ndërtimin e njësisë së shërbimit është deklaruar vlera prej 300.000 lekësh në vitin 2009, si dhe në DIPP-në e vitit 2010 është deklaruar kryerja e pagesës prej 716.000 lekësh për legalizim e saj.
47. Nga analizimi i DIPP-së së vitit 2012 ka rezultuar se subjekti ka deklaruar shitjen e njësisë së shërbimit³¹ me nr. pasurie ***, me anë të kontratës së shitblerjes datë 11.6.2012, me palë blerëse “****” sh.p.k., kundrejt çmimit total 8.800.000 lekë, paguar jashtë zyrës noteriale³². Nga kjo shumë z. A. H. i ka transferuar z. Kasem Berberi vetëm vlerën prej 5.000.000 lekësh në llogarinë e tij në “Credins Bank” në datën 20.6.2012. Lidhur me përfitimin e kësaj shume rezultoi se subjekti e ka deklaruar atë në rubrikën përkatëse të DIPP-së së vitit 2012, si e ardhur e përfituar nga shitja e njësisë së shërbimit.
48. Në vijim të shqyrtimit të dokumentacionit bankar ka rezultuar se, më tej, subjekti shumë prej 5.000.000 lekësh e ka investuar në një depozitë me afat dhe prej saj ka tërhequr në datën 19.1.2015 shumë 1.791.800 lekë³³, të deklaruar si një nga burimet e krijimit, ndërsa shumë prej 1.900.000 lekësh ai e ka transferuar në llogari të djalit të tij, z. D. B.
49. Rezultoi se nga analizimi i dokumentacionit të llogarive bankare të djalit të subjektit të rivlerësimit në datën 19.1.2015, ai ka tërhequr shumë 1.900.000 lekë nga llogaria e tij në “Credins Bank”, shumë kjo që i ishte transferuar më herët nga babai i tij.

³⁰ Shkresë nr. *** prot., datë 28.8.2020.

³¹ Referuar vërtetimit hipotekor nr. ***, datë 30.5.2012, rezultoi se kjo pasuri është rivlerësuar në shumë 8.800.000 lekë.

³² Në këtë kontratë subjekti dhe bashkëshortja e tij kanë qenë të përfaqësuar nga z. A. H.

³³ Pjesa tjetër e depozitës fillestare prej 5.000.000 lekësh ishte përdorur si në vijim: shuma 1.043.000 lekë është përdorur në qershor 2013 për mbylljen e një kredie të marrë në janar 2013, ndërsa shuma 2.500.000 lekë i është dhënë hua z. A. H.

50. Pas shqyrtimit të lëvizjeve të llogarisë bankare të subjektit rezultoi se shuma e transferuar prej tij në favor të të birit ishte pjesë e shumës 4.000.000 lekë, të transferuar më herët te llogaria e vet subjektit nga z. A. H. (nipi i subjektit), në datën 18.2.2014, me përshkrimin “likuidim detyrimi”.
51. Lidhur me burimin e shumës së lartpërmendur subjekti ka deklaruar në DIPP-në e vitit 2014 se shuma 4.000.000 lekë përbëhet nga: (i) vlera 2.500.000 lekë të dhëna hua nipit të tij në dhjetor të vitit 2013; dhe (ii) vlera 1.500.000 lekë nga të ardhurat e shoqërisë “****”³⁴ sh.p.k. Nga shqyrtimi i llogarive bankare të subjektit Komisioni konstatoi se ai i ka rikthyer sërish z. H. shumën prej 1.500.000 lekësh me përshkrimin “kthim borxhi”, në datën 3.6.2014.
52. Pasi është ripyetur nga Komisioni, nëpërmjet pyetësorit nr. 3, për të shpjeguar marrëdhënien juridiko-civile midis vetë subjektit, shoqërisë “****” sh.p.k. dhe z. H., për sa i përket transferimit të shumës 1.500.000 lekë në favor të tij, ky i fundit është shprehur se deklarimi i tij i mëparshëm nuk ka qenë i saktë. Pasi është konsultuar me DIPP-të e tij ndër vite, por edhe sqarimeve të dhëna nga nipi i tij, z. A. H., shuma prej 1.500.000 lekësh i përket të ardhurave nga shitja e lokalit shoqërisë “****” sh.p.k. dhe se ai në fakt ka marrë nga shitja e shtesës së legalizuar, në total shumën 6.500.000 lekë.
53. Komisioni, nisur nga sa u pretendua më sipër mbi përfitimin e shumës 1.500.000 lekë nga shitja e njësisë së shërbimit, vlerëson se pretendimi i subjektit është kontradiktor dhe nuk vjen në harmoni me deklarin në DIPP-në e atij viti dhe, po ashtu, nuk përputhet me atë çfarë rezulton nga dokumentacioni i administruar nga hetimi administrativ, për sa kohë, kjo shumë i është rikthyer dërguesit me përshkrimin “kthim borxhi”. Po ashtu, nuk rezulton të jetë rimarrë kjo shumë më prej tij dhe as të jetë deklaruar më në ndonjë nga deklaratat periodike në vijimësi prej tij.
54. Megjithatë, përpos mospërputhjeve dhe pasaktësive të mësipërme në deklarime dhe në përgjigje të pyetësorëve, referuar dokumentacionit të disponuar, u gjet e provuar nga Komisioni se shumat 1.791.800 lekë dhe 1.900.000 lekë të përdorura dhe të deklaruara si pjesë e burimit për blerjen e apartamentit në pronësi të djalit të subjektit kanë burim financiar të ligjshëm, pasi ato janë krijuar nga të ardhurat e realizuara nga shitja e njësisë së shërbimit.
55. Në këto kushte Komisioni përllogariti vetëm shumën 5.000.000 lekë të deklaruar, ndërsa shumën prej 1.500.000 lekësh nuk e përfshiu në analizën financiare si burim krijimi dhe, për pasojë, kjo shumë nuk passjellë ndryshim në raport me burimet financiare të përdorura për blerjen e pasurisë.

3.1.1.1. Lidhur me disa veprime financiare në raport me njësinë e shërbimit

56. Lidhur me transferimin vetëm të shumës 5.000.000 lekë nga shitja e njësisë së shërbimit, subjekti sqaroi se ka përfituar shumën e sipërcituar, ndërsa diferenca është mbajtur nga nipi i tij për shkak të detyrimeve që kishte ndaj tij, pasi ai kishte ndjekur e kontribuar për ndërtimin e njësisë së shërbimit dhe të procedurave për legalizimin, duke u shprehur se do të likuidohej me nipin e tij në momentin e shitjes.

³⁴ Z. D. B., ortak në shoqëri me nipin e tij.

57. Nga sa më sipër, Komisioni i kërkoi subjektit të shpjegonte arsyet e mbajtjes së shumës në fjalë nga z. A. H., ndërkohë që shpenzimet – sipas dokumentacionit – ishin kryer nga nipi tjetër, z.A.H., si dhe të paraqiste dokumentacion ligjor provues për marrëdhënien juridiko-civile midis tyre. Në përgjigje të sa më sipër, subjekti shpjegoi se z. A. dhe z. A. janë vëllezër mes tyre dhe se ata kanë punuar bashkërisht, edhe marrëdhëniet financiare i kanë pasur të përbashkëta.
58. Nisur nga fakti që shumat e lartpërmendura kanë si burim të ardhurat e përfituara nga shitja e një pasurie të paluajtshme, Komisioni e analizoi atë prej momentit fillestar të krijimit dhe kryesisht të mundësisë së ndërtimit me burime financiare të ligjshme të mjaftueshme të disponuara nga vetë subjekti.
59. Lidhur me pretendimin e subjektit mbi ekzistencën e një marrëdhënieje/dakordësie me nipin e tij për financimin e pjesshëm dhe të përkohshëm të punimeve të kryera për njësinë në analizë (e cila mund të konsiderohet si huamarrje mes subjektit të rivlerësimit dhe nipit të tij, z. A. H., pikërisht për mbulimin e kostove të ndërtimit dhe të legalizimit³⁵ të objektit në analizë), vërehet se kostoja e ndërtimit nuk është deklaruar në DIPP-të ndër vite dhe as në deklaratën *Vetting*, ndonëse kanë rezultuar disa transferta bankare të ndërsjella.
60. I pyetur në lidhje me mosdeklarimin ndër vite të marrëdhënies financiare me nipin e tij, ai shpjegoi se e kishte vlerësuar të panevojshme për t'u pasqyruar në deklaratat periodike, meqenëse nuk i kishte kryer ai vetë këto shpenzime.
61. Në këto kushte, si dhe në mungesë të dokumentacionit provues të ekzistencës së huas/financimit të pretenduar nga nipi i tij, Komisioni përllorarit në analizë financiare shpenzimet duke i konsideruar ato si të përballuara nga vetë subjekti i rivlerësimit në momentin e kryerjes së tyre, ndërsa për periudhën e ndërtimit të njësisë së shërbimit bëri me dije se punimet kryesore janë kryer përgjatë periudhës tetor 2005 - maj 2006.
62. Nga praktika e depozituar nga ALUIZNI dhe ASHK Gjirokastër rezultoi se procedurat për legalizimin e objektit informal kanë nisur në vitin 2006, me dorëzimin e formularit të vetëdeklarimit nr. *** prot., datë 8.9.2006³⁶ që konfirmon përfundimin e punimeve. Gjithashtu, ALUIZNI³⁷ bashkëlidhi dokumentin leje legalizimi nr. ***, datë 26.11.2010 “Për legalizimin e shtesës anësore *** kate, për banim dhe shërbim në objektin ekzistues *** kat” në emër të shtetasve Kasem Berberi, S. Z. dhe V. L., me sipërfaqe totale ndërtimore 111 m² (nga ku sipërfaqja prej 54.12 m² për banim dhe sipërfaqja 44 m² për aktivitet ekonomik), si dhe kontratën për kalimin e titullit të pronësisë³⁸ datë 18.6.2010³⁹, të nënshkruar mes ALUIZNI-t dhe shtetasve të sipërcituar.
63. Referuar deklarimit të subjektit në DIPP-në e vitit 2009 për ndërtimin e njësisë së shërbimit rezulton se ai ka deklaruar punime shtesë në njësinë e shërbimit për të cilën është paguar vlera 300.000 lekë, duke shpjeguar se nuk disponon ndonjë dokumentacion të kohës për të provuar

³⁵ Në përgjigje të pyetësorit nr. 3, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se shuma për legalizimin e objektit është paguar prej tij dhe se gabimisht është deklaruar se është paguar nga nipi i tij, pasi ka kaluar një kohë e gjatë, çka ka sjellë pasaktësi.

³⁶ ASHK Gjirokastër, me shkresën nr. *** prot., datë 13.12.2022, përcolli formularin e vetëdeklarimit.

³⁷ Shkresë nr. *** prot., datë 1.11.2018.

³⁸ Parcela ndërtimore nr. ***.

³⁹ Sipërfaqja prej 111 m² është pjesëtuar ndërmjet tyre sipas kontratës datë 21.11.2011.

ndërtimin e tij. Me qëllim që të provonte vlerën e këtij investimi, në përgjigje të pyetësorit nr. 3 ai paraqiti një situacion punimesh të kryer nga një inxhinier ndërtimi, i cili për përcaktimin e vlerës së investimit ka përdorur çmimet e manualit të preventivimit të Entit Kombëtar të Banesave të vitit 2008 me një kosto totale ndërtimi prej 1.001.160 lekësh.

64. Komisioni, me qëllim përlllogaritjen e kostos së ndërtimit të njësisë, e ka kryer përlllogaritjen duke përdorur referencat mesatare të publikuara nga EKB-ja, sipas udhëzimeve përkatëse të viteve 2005⁴⁰ dhe 2006⁴¹ për kostot mesatare të ndërtimit të banesave të ndarë përkatësisht sipas muajve takues të secilit vit, si dhe duke zbritur fondin rezervë dhe fitimin e planifikuar, referuar kjo jurisprudencës së Kolegjit⁴², në përfundim të së cilës do të rezultonte një kosto ndërtimi prej 1.037.714 lekësh, për një objekt me sip. 44 m², që është e përafërt me vlerën e pasqyruar në situacionin e punimeve të paraqitur prej subjektit.
65. Ndërsa, për sa i takon diferencës që rezulton ndërmjet kostos së ndërtimit dhe çmimit të shitjes së pasurisë, ai shpjegon se kjo njësi shërbimi ndodhet në një zonë tregtare të qytetit të Gjirokastrës, ku dhe aktualisht është tregu i qytetit për shitjet me shumicë/pakicë⁴³. Gjithashtu, ai bëri me dije se prej tij nuk është kryer asnjë investim në këtë njësi me qëllim rritjen e vlerës.
66. Ndërsa për sa i takon ekzistencës së konfliktit të interesit me palën blerëse, administratorin apo ortakët e shoqërisë, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me shkresën nr. *** prot., datë 11.10.2020, ka bërë me dije se për periudhën 2015 – 2022, në emër të tyre nuk janë regjistruar procedime penale të hetuara nga subjekti i rivlerësimit.

Tabela nr. 3 – Analiza e burimeve për ndërtimin e njësisë së shërbimit

Te terhequra nga pagat e subjektit 1.6.2005 - 31.12.2005	747,000
Shpenzime jetese 1.6.2005 - 31.12.2005 (3 persona)	(191,725)
Kosto e ndertimit tetor - dhjetor 2005	(383,200)
Rezultati në 31.12.2005	172,075
Te terhequra nga pagat e subjektit 1.1.2006 - 31.5.2006	995,000
Te terhequra nga pagat e b/shortes 1.1.2006 - 31.5.2006	850,000
Shpenzime jetese 1.1.2006 - 31.5.2006 (3 persona)	(136,946)
Shpenzime mobilimi	(200,000)
Kosto e ndertimit janar - maj 2006	(654,515)
Rezultati në 31.5.2006	853,539

67. Për ndërtimin e shtesës anësore përgjatë periudhës tetor 2005 – maj 2006 subjekti ka pasur mjaftueshmëri të burimeve të ligjshme financiare. Kjo analizë është kryer duke përlllogaritur shumat e tërhequra nga llogaritë e pagave të subjektit dhe bashkëshortes së tij, të krijuara me

⁴⁰ Referuar udhëzimit nr. 5, datë 23.11.2005 “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave dhe të koeficientit ‘k’ për vitin 2005”, kostoja mesatare e ndërtimit për qytetin e Gjirokastrës në vitin 2005 ka qenë 25.614 lekë/m².

⁴¹ Referuar udhëzimit nr. 5, datë 7.9.2006 “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave, dhe të koeficientit ‘k’ për vitin 2006”, kostoja mesatare e ndërtimit për qytetin e Gjirokastrës në vitin 2006 ka qenë 26.267 lekë/m².

⁴² Vendimi nr. 6, datë 17.3.2022 (JR) dhe ai nr. 7, datë 29.3.2022 (JR).

⁴³ Shoqëruar me foto.

burim të ardhurat nga pagat. Në vijim të analizës financiare të pasurisë nr. 2, për sa kohë nga analiza deri në datën 31.5.2005 nuk ka mbetur ndonjë shumë për t’u përdorur në vijim për këtë ndërtim, analiza ka filluar në datën 1.6.2005.

3.1.2. Analizimi i burimit të krijimit të huas së marrë nga shtetasja E. Sh.⁴⁴

68. Subjekti, përveç sa më sipër është analizuar, si burim krijimi të përdorur për blerjen e pasurisë apartament në pronësi të djalit të tij, ka deklaruar edhe huan e marrë nga kunata e tij E. Sh., në shumën 2.000.000 lekë. Për të provuar ekzistencën e marrëdhënies së huas, Komisioni i kërkoi subjektit të paraqiste dokumentacionin ligjor që provon mënyrën dhe kohën e dhënies së huas, si dhe burimin e ligjshëm të të ardhurave që kanë shërbyer për kursimin e shumës së dhënë hua nga huadhënësja.
69. Në përgjigje të sa më sipër, subjekti informoi se shtetasja E. Sh. ka pasur kursime në depozitë pranë “Credins Bank”, të cilat i ka tërhequr në datën 21.1.2015, duke paraqitur edhe dokumentin provues “mandat tërheqje” nga kjo bankë të shumës 2.000.000 lekë. Gjithashtu, në përgjigje të pyetësorit nr. 4, vuri në dispozicion edhe një deklaratë noteriale⁴⁵ të datës 28.1.2023 të huadhënësës, ku kjo e fundit deklaroi se në muajin janar 2015 i ka dhënë hua shumën prej 2.000.000 lekësh nipit të saj për blerjen e një apartamenti në Tiranë, ndërsa lidhur me kthimin e huas ajo deklaroi se huaja do t’i kthehet në momentin që do të përfitohet kompensimi financiar nga tokat e shpronësuar⁴⁶.
70. Ndërsa për të provuar burimin e ligjshëm të krijimit të huas prej 2.000.000 lekësh nga huadhënësja, në përmbushje të kushteve dhe kritereve të vendosura nga ligji për provueshmërinë e ligjshmërisë së burimit të të ardhurave të huadhënësit, subjekti vuri në dispozicion lëvizjet e llogarisë bankare të pagës dhe lëvizjet e llogarisë së depozitës së huadhënësës, ku u konstatua se ishte tërhequr prej saj shuma e dhënë hua prej 2.000.000 lekësh në janar të vitit 2015.
71. Referuar dokumentacionit bankar të shtetasës E. Sh., të paraqitur nga subjekti duke filluar nga viti 2005 e deri në fund të vitit 2014, Komisioni ka konstatuar se nga shtetasja Sh. janë realizuar të ardhura me burim krijimi nga pagat e saj në masën 9.804.893 lekë. Komisioni, pas përlllogaritjes së shpenzimeve të jetesës për familjen e saj, i rezultoi se ata kanë pasur mjaftueshmëri të burimeve të ligjshme financiare për dhënien e huas prej 2.000.000 lekësh subjektit, sipas detajimit në tabelën e mëposhtme. Gjithashtu, nga lëvizjet e llogarive bankare të depozitës së shtetasës Sh., në datën 20.5.2013 asaj i është kredituar nga shitja e bonove të thesarit shuma 3.009.577 lekë, nga e cila në datën 21.1.2015 është tërhequr nga shtetasja Sh. vlera prej 2.000.000 lekësh.

Tabela nr. 4 – Analiza e burimeve për dhënien e huas 2.000.000 lekë

Te ardhura nga pagat e zj. Sh. 2005 - 2014	9,804,893
Shpenzime jetese 2005 - 2014 (3 persona)	(4,172,186)
Dhene hua subjektit te rivleresimit ne janar 2015	(2,000,000)
Rezultati	3,632,708

⁴⁴ Referuar ligjit nr. 84/2016, znj. Sh. konsiderohet “person tjetër i lidhur” për shkak të marrëdhënies së interesit, duke pasur detyrimin për të justifikuar burimin e ligjshëm të huas, sipas përcaktimeve ligjore.

⁴⁵ Deklaratë noteriale nr. ***.

⁴⁶ Bashkëlidhur vendimin e AKKP-së për kompensimin e familjes B..

72. Trupi gjykues vlerëson se huadhënësja E. Sh. ka pasur mjaftueshmëri të burimeve të ligjshme financiare për dhënien e huas së përdorur si një nga burimet e krijimit të blerjes së kësaj pasurie.
73. Ndërsa lidhur me ndërtimin e njësisë së shërbimit, trupi gjykues konstaton se për ndërtimin e saj përgjatë viteve 2005 dhe 2006, subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar kryerjen e shpenzimeve përkatëse apo mbulimin e këtyre shpenzimeve nga ana e nipit të tij, gjë e cila nuk çmohet penalizuese për aq kohë sa edhe nga analiza financiare rezulton një mjaftueshmëri e burimeve të ligjshme financiare.
74. Nga sa më sipër, lidhur me pasurinë e llojit apartament në pronësi të djalit të subjektit, trupi gjykues vlerëson se për sa i takon kryerjes së pagesës në shumën 3.691.000 lekë për blerjen e apartamentit, subjekti ka pasur mjaftueshmëri të burimeve të ligjshme financiare, pasi ato burojnë nga të ardhura të ligjshme nga shitja e njësisë së shërbimit.

4. Lokali “*” në bashkëpronësi, Gjirokastrë**

75. Pasuri “***” është deklaruar në DIPP-në e vitit 2003, si dhe në deklaratën *Vetting* si pasuri e përfituar nëpërmjet nënshkrimit të kontratës së shitblerjes në bashkëpronësi me të afërmin e tij F.B., në vitin 1994, kundrejt vlerës totale prej 247.000 lekësh, me palë shitëse Ndërmarrja *** – Gjirokastrë, me burim krijimi kursimet familjare. Në këtë kontratë është përshkruar se pagesa e çmimit të blerjes është kryer sipas mandatit të datës 18.8.1993. Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti ka bërë me dije se në vitin 1993 ka realizuar të ardhura, por nuk ka paraqitur dokumentacion lidhur me to.
76. Pasuria është regjistruar sipas dokumentit hipotekor nr. ***, datë 27.12.2007, në emër të shtetasve F. B. dhe Kasem Berberi⁴⁷. Nga dokumentacioni i disponuar për këtë pasuri ka rezultuar se në vitin 2007 bashkëpronari tjetër F. B. ia ka shitur pjesën e tij takuese shtetasës M. H. (motra e subjektit) me anë të kontratës së shitblerjes⁴⁸ datë 29.12.2007 kundrejt çmimit 3.000.000 lekë⁴⁹.
77. Pyetur nga Komisioni lidhur me statusin juridik aktual të kësaj pasurie, subjekti informoi se objekti “***” aktualisht i është dhënë me qira shtetasit P. B. me anë të kontratës së qirasë⁵⁰ datë 29.10.2015. Pagesa e qirasë⁵¹ bëhet dorazi dhe tatimi mbi të ardhurat për këtë objekt paguhet rregullisht nga qiramarrësi. Për të provuar sa më sipër, subjekti paraqiti vërtetimin nr. *** prot., datë 12.10.2022, të lëshuar nga sektori i shërbimit të tatimpaguesve Gjirokastrë për kryerjen e pagesave të tatimit në burim për periudhën 2018 – 2022 nga qiramarrësi.
78. Lidhur me këto të ardhura nga qiraja, Komisioni vlerëson se për sa kohë nuk kanë rezultuar të paguara detyrimet tatimore për të ardhurat nga qiradhënia përgjatë viteve 2015 dhe 2016, nuk janë konsideruar si të ardhura me burim të ligjshëm financiar në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.

⁴⁷ Pagesa e çmimit të blerjes në vitin 1993, subjekti nuk ka paraqitur dokumentacion për të ardhurat e përfituara të kësaj periudhe.

⁴⁸ Kontratë nr. ***.

⁴⁹ Subjekti nuk ka pasur pretendime, e ka dhënë pëlqimin me deklaratën noteriale nr. ***, datë 28.12.2007.

⁵⁰ Kontratë nr. ***.

⁵¹ Në DIPP-në e vitit 2015, deklaruar 22.500 lekë; DIPP-në e vitit 2016, deklaruar 160.000 lekë.

79. Nga sa më sipër, trupi gjykues ka konstatuar se nuk janë evidentuar problematika për sa i përket deklaratimit të kësaj pasurie apo mënyrës së përfitimit të saj, për sa kohë përfitimi i saj rrjedh nga një kontratë privatizimi.
80. Lidhur me dokumentacionin ligjor që provon burimin e ligjshëm të të ardhurave të përdorura për blerjen e pjesës takuese të kësaj pasurie, meqenëse nga subjekti nuk u arrit të provohej, ato mbeten vetëm në nivel deklarativ. Megjithatë, për aq kohë sa vlera financiare rezultoi të jetë minimale, si dhe është e provuar se pagesa për privatizimin/blerjen e këtij objekti është kryer shumë vite përpara fillimit të detyrës nga subjekti, Komisioni vlerëson se në këto kushte nuk evidentohet ndonjë situatë që mund të passjellë penalizim të subjektit të rivlerësimit.

5. Pasuria e llojit “truall” me sipërfaqe 67 m², në Gjirokastrë

81. Në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar pronësinë e një sipërfaqeje trualli prej 67 m², që i përket truallit të lokalit të sipërcituar, shoqëruar me dokumentin e lëshuar nga ZVRPP-ja Gjirokastrë⁵², ku informohet se pasuria truall ndodhet në lagjen “****”, Gjirokastrë dhe se është përfituar me kërkesën e subjektit për ndarje pasurie.
82. Gjithashtu, ASHK-ja Gjirokastrë⁵³ konfirmoi ndarjen e pasurisë me nr. ***, të përbërë nga 111 m² truall, mbi të cilin ngrihet një njësi me sip. 44 m² e ndarë në dy pjesë (përkatesisht pasuria nr. *** e llojit “truall”, mbi të cilin ngrihet njësi me sip. 44 m² dhe pasuria në analizë nr. ***, me sipërfaqe trualli 67 m²). Kjo pasuri ishte përfituar më herët prej tij (me anë të pjesëtimit të një pasurie të përbashkët)⁵⁴ dhe përbëhet nga sipërfaqja 111 m² truall, si dhe një shtesë anësore pallati me tri kate, e kombinuar me funksion banimi dhe funksion ekonomik⁵⁵.
83. Nga shqyrtimi dhe analizimi i DIPP-ve ndër vite nuk rezulton që subjekti i rivlerësimit të ketë deklaruar qartësisht përfitimin e sipërfaqes së truallit si më sipër, ndonëse në DIPP-në e vitit 2010 ai kishte deklaruar kryerjen e shpenzimit në shumën 716.400 lekë, të paguar prej tij për procedurat e legalizimit të objektit dhe të sipërfaqes së parcelës ndërtimore.
84. Nga analiza financiare e kryer nga Komisioni rezultoi se, pasi janë përlllogaritur të ardhurat dhe shpenzimet e familjes së subjektit deri në datën e kryerjes së pagesës së legalizimit⁵⁶, 18.6.2010, ata kanë pasur një mungesë të burimeve të ligjshme financiare në masën -201.955 lekë.

Tabela nr. 5 – Analiza e burimeve për pagesën e legalizimit

Te terhequra nga pagat e subjektit 1.1.2010 - 18.6.2010	815,000
Te terhequra nga pagat e b/shortes 1.1.2010 - 18.6.2010	150,000
Shpenzime jetese janar - qershor 2010 (3 persona)	(204,930)
Shpenzime udhetimi janar - qershor 2010	(58,300)
Te depozituara per shlyerje te kredise ne RZB	(176,800)
Shpenzim per legalizimin e objektit	(726,925)
Rezultati në 18.6.2010	(201,955)

⁵² Vërtetim nr. *** prot., datë 8.11.2016.

⁵³ Shkresë nr. *** prot., datë 28.8.2020.

⁵⁴ Pasuria e sipërcituar sipas kontratës së pjesëtimit nr. ***, datë 21.11.2011.

⁵⁵ Kati përdhe me sip. 44 m², kati i parë banesë me sip. 48.9 m² dhe kati i dytë banesë me sip. 54.12 m² dhe nga pjesëtimi ai ka përfituar truallin me sip. 111 m² dhe njësinë mbi të me sip. 44 m².

⁵⁶ Përfshirë edhe pagesat e kryera për tarifën e shërbimit prej 4.000 lekësh dhe taksën e ndikimit në infrastrukturë prej 12.995 lekësh.

85. Komisioni i kërkoi subjektit nëpërmjet pyetësorit nr. 3 të bënte me dije nëse mbi këtë sipërfaqe trualli ishte kryer ndonjë investim, duke i kërkuar të vinte në dispozicion edhe koordinatat hapësinore të pasurisë. Ky i fundit vuri në dispozicion disa foto të gjendjes aktuale të njësisë së shërbimit, nga të cilat evidentohet me sy të lirë se mbi këtë pasuri nuk ka ndonjë investim/ndërtim⁵⁷.
86. Nga sa më sipër, Komisioni vlerësoi se nuk janë konstatuar problematika lidhur me krijimin e kësaj pasurie për aq kohë sa ajo është përfituar nëpërmjet nënshkrimit të kontratës me ALUIZNI-n Gjirokastër.
87. Ndërsa lidhur me kryerjen e pagesës për legalizimin e objektit dhe përfitimin e parcelës ndërtimore në analizë, Komisioni ka konstatuar se subjekti ka pasur një mungesë të burimeve të ligjshme financiare në masën -201.955 lekë.
88. Në vijim të mbylljes së hetimit administrativ, Komisioni, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe paragrafit 5 të nenit Ç të Aneksit të Kushtetutës, i kaloi subjektit barrën e provës për të paraqitur dokumentacionin ligjor për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit lidhur me të gjitha problematikat e konstatuara për pasurinë në fjalë.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

89. Në shpjegimet e depozituara nga subjekti i rivlerësimit, ai shpjegoi se nga ana e Komisionit sipas tabelës nr. 3 është përlllogaritur shuma 654.515 lekë si kosto ndërtimi e paguar prej tij në periudhën 2005 – 2006, shumë që nuk është paguar nga ai dhe, si e tillë, ajo nuk duhet të përfshihet në shpenzimet e kryera në periudhën 1.1.2010 - 18.6.2010. Po ashtu, edhe ndërtimi i objektit, procedurat e legalizimit të tij, si dhe të gjitha detyrimet e tjera financiare janë paguar nga nipi i tij dhe se ai vetë ka paguar në kohën e ndërtimit të objektit vetëm shumën prej 300.000 lekësh, duke rënë dakord që kur të shitej objekti do të likuidohet në vlerën që kishte shpenzuar.
90. Lidhur me mundësinë e ekzistencës së burimeve të ligjshme financiare për këtë ndërtim, sqaroi se, nëse ai do të kishte kryer shpenzime të tjera, nuk ka pasur arsye për të mos i deklaruar, pasi në këtë periudhë kishte burime të ligjshme që të justifikonte këto pagesa, duke konsideruar se shpenzimi prej 716.400 lekësh mbulohej nga të ardhurat që ka pasur deri në datën 18.6.2010, duke mos pasur pretendime të tjera lidhur me analizën financiare të burimeve të pasurisë në fjalë.

Vlerësimi i trupit gjykues

91. Lidhur me sa më sipër, trupi gjykues arrin në përfundimin se në kushtet kur nga subjekti nuk u depozitua ndonjë dokumentacion provues, rezultati i arritur në mbylljen e hetimit administrativ dhe i njoftuar subjektit të rivlerësimit nuk ndryshon.
92. Gjithsesi, Komisioni vlerëson se pamundësia financiare në masën -201.955 lekë për kryerjen e pagesës për legalizimin e objektit dhe përfitimit të parcelës ndërtimore nuk mund të penalizojë subjektin e rivlerësimit, për sa kohë bëhet fjalë për një vlerë minimale, jo e mjaftueshme që të sillte penalizimin e tij.

⁵⁷ Foto të printuara nga *Google Maps* – identifikohet objekti/koordinata të përgjithshme të përshkruara në to.

6. Pasuri të përfituara me anë të trashëgimisë

93. Në deklaratën *Vetting*, subjekti ka deklaruar se ai dhe trashëgimtarët e tjerë të gjyshit të tij kanë përfituar një sipërfaqe toke, në të cilën shoqëria ndërtuese “****” sh.p.k. ka ndërtuar një pallat ***-katësh, nga ku më herët mes tyre është nënshkruar kontratë shkëmbimi, ku ai ka përfituar 1/42 pjesë të saj.
94. Lidhur me këtë pasuri, ASHK-ja Gjirokastër⁵⁸ informoi se në emër të tij, ndër të tjera, figurojnë të regjistruara pasuritë në bashkëpronësi: njësi shërbimi me nr. pasurie ***, me sip. 92.9 m²; apartament banimi me nr. ***, me sip. 76.8 m²; njësi shërbimi me nr. ***, sip. 92.9 m²; apartament banimi me nr. ***, me sip. 76.3 m²; njësi shërbimi me nr. ***, me sip. 93.75 m²; njësi shërbimi me nr. ***, me sip. 93.75 m²; apartament banimi me nr. ***, me sip. 76.8 m². Pjesë e dokumentacionit rezultoi kontrata e shkëmbimit e vitit 2006, e nënshkruar nga bashkëpronarët Berberi dhe shoqëria e ndërtimit “****” sh.p.k., nga ku vërehet se janë shkëmbyer pasuritë e sipërcituara në këmbim të sipërfaqes së truallit për ndërtimin prej 780 m² të përfituar nga trashëgimia, për të cilin depozitoi edhe aktet e trashëgimisë⁵⁹.
95. Pyetur nga Komisioni lidhur me mosdeklarimin në DIPP-të përkatëse të kontratës së shkëmbimit me shoqërinë “****” sh.p.k., ai shpjegoi se fillimisht e ka deklaruar në DIPP-në e vitit 2003, së bashku me pronësinë mbi dy dyqane nga 50 m², duke vënë në dispozicion edhe vendimin e KKKP-së me nr. ***, datë 19.2.1996⁶⁰, nga ku pas shkëmbimit të një pjese të truallit prej 780 m² me shoqërinë bashkëpronarëve u ka mbetur një sipërfaqe trualli prej 280 m², evidentuar si pasuria nr. ***.
96. Komisioni ka konstatuar se referuar deklarimit në DIPP-në e vitit 2003 ai ka deklaruar dy dyqane me sip. 50 m² secili dhe në rubrikën e burimit të krijimit ka shënuar “përfituar nga firmë ndërtimi duke i dhënë truallin trashëgimi nga babai” dhe, po ashtu, ka deklaruar një sipërfaqe prej 100 m² truall, me pjesë takuese 1/6, me burim krijimi “kthim prone nga babai”.
97. Pyetur nga Komisioni lidhur me këto dy dyqane, ai sqaroi se: *“Para se të ndërtohej objekti nga shoqëria ‘****’ sh.p.k., gjithë trashëgimtarët e ish-pronarit S. B. kanë rënë dakord, në marrëveshje me njëri-tjetrin, jo e formalizuar me shkrim, se në katin e parë të objektit do të përfitonin ambiente 4 trashëgimtarët e radhës së parë. Menjëherë pasi është ndërtuar objekti, ende pa përfunduar, sipas marrëveshjes së mësipërme, përfitoj një njësi në katin e parë, rreth 100 m², të cilën e kanë pasur në përdorim dy motrat e mia që jetojnë në Gjirokastër, M. H. dhe E. B., si dhe kam rënë dakord që të hiqja dorë nga pronësia për pjesën time takuese, pa kundërshpërblim, pasi vetë personalisht kisha përfituar pronësinë e lokalit që kam privatizuar”*.
98. Në përfundim të sa më sipër, Komisioni nuk konstatoi problematika lidhur me burimin e ligjshëm të krijimit të pasurive në fjalë, për sa kohë ato janë përfituar fillimisht nëpërmjet trashëgimisë ligjore e, më pas, nga pjesa takuese e kontratës së shkëmbimit të pasurive me shoqërinë ndërtuese

⁵⁸ Shkresë nr. *** prot., datë 28.8.2020.

⁵⁹ Sipas vendimit nr. ***, datë 20.7.2004, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

⁶⁰ Dëshminë e trashëgimisë me nr. ***, datë 14.12.1993, sipas së është regjistruar pasuria nr. ***, në z. k. ***, me sip. 1.060 m².

“****” sh.p.k. Komisioni i kërkoi subjektit të rivlerësimit të jepte shpjegime bindëse mbi sa është konstatuar.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

99. Subjekti i rivlerësimit në prapësime shpjegoi se para se të ndërtohej objekti nga shoqëria “****” sh.p.k. të gjithë trashëgimtarët kishin rënë dakord që do të përfitonin ambiente, fillimisht katër trashëgimtarët e radhës së parë, ku babai i tij përfitoi një njësi në katin e parë, të cilën e kanë përdorur motrat e tij, për të cilën ai ka hequr dorë nga pronësia mbi pjesën takuese. Gjithashtu, ai kishte deklaruar në DIPP-në e vitit 2003 përfitimin e një sipërfaqeje 100 m² me pjesë takuese 1/6, me burim krijimi po nga babai dhe se ky deklaram lidhet me pjesën takuese të pasurisë në emër të babait të tij.
100. Ndërsa, për sa i takon mosdeklarimit të kontratës së shkëmbimit në DIPP-në e vitit 2006, në prapësime subjekti shpjegoi se ai nuk e ka deklaruar kontratën e shkëmbimit, pasi i kishte deklaruar ato më parë, në DIPP-në e vitit 2003, dhe se vetëm pas përfundimit të pallatit në tokën e trashëguar, në vitin 2002 – 2003, u bë ndarja e pasurisë *de facto*, sipas marrëveshjes që ishte arritur më herët mes trashëgimtarëve.

Vlerësimi i trupit gjykues

101. Nisur nga shpjegimet e subjektit të rivlerësimit, por edhe nga dokumentacioni i administruar përgjatë hetimit administrativ, nga ku konfirmohet dinamika deklaruese dhe paralelisht edhe evoluimi i dakordësimeve të materializuara mes trashëgimtarëve (mes tyre edhe subjekti), mbi planin/idenë zhvillimor/e për ndërtimin e përbashkët mbi truallin në fjalë, Komisioni i vlerëson shpjegimet e subjektit bindëse dhe shteruese, duke mos konstatuar rrethana penalizuese në raport me përfitimin, burimin dhe deklaramin, në kuadër të procesit të rivlerësimit.

7. Automjet tip “**”**

102. Automjeti është deklaruar në DIPP-në e vitit 2009 e, më pas, në deklaratën *Vetting* si një pasuri e fituar me anë të kontratës së shitblerjes⁶¹ datë 25.5.2009, nga pala shitëse I. N.⁶² kundrejt çmimit 850.000 lekë, me burim krijimi kursimet familjare. Në vijim të hetimit administrativ, DPSHTRR-ja⁶³ informoi se automjeti ka qenë i regjistruar në emër të subjektit nga data 21.2.2020 deri më 28.2.2020, duke rezultuar si i regjistruar në emër të subjektit shumë vite pas blerjes së tij. Më pas, ky automjet i është shitur shtetasit M. M. kundrejt çmimit 150.000 lekë, duke bashkëlidhur kontratën e shitblerjes së vitit 2020, informacion i cili konfirmohet edhe nga DPSHTRR-ja⁶⁴.
103. I pyetur nga Komisioni lidhur me përdorimin e këtij automjeti, subjekti paraqiti kontratën e vitit 2013 të përdorimit të këtij automjeti nga djali i tij D. B. dhe, po ashtu, sqaroi se në vitin 2009 automjeti është blerë nga shtetasi I. N. kundrejt çmimit 850.000 lekë.

⁶¹ Kontratë nr. ***.

⁶² Automjeti është blerë në shtetin italian kundrejt çmimit 2.350 euro dhe zhdoganuar në shumën 230.384 lekë.

⁶³ Shkresat nr. *** prot., datë 5.10.2022, si dhe nr. *** prot., datë 25.11.202.

⁶⁴ Shkresë nr. *** prot., datë 25.11.2022.

104. Për sa i përket mundësisë financiare për blerjen e automjetit, pas përllogaritjes së të ardhurave dhe shpenzimeve të familjes së subjektit, deri në datën e blerjes së automjetit 25.5.2009, rezultoi se ata kanë pasur mjaftueshmëri të burimeve të ligjshme financiare.

Tabela nr. 6 – Analiza e burimeve për blerjen e automjetit

Te terhequra nga pagat e subjektit 1.1.2009 - 25.5.2009	512,000
Te terhequra nga pagat e b/shortes 1.1.2009 - 25.5.2009	640,000
Shpenzime jetese 1.1.2009 - 25.5.2009	(170,775)
Shpenzime te tjera 1.1.2009 - 25.5.2009	-
Shpenzim per blerjen e automjetit	(850,000)
Rezultati në 25.5.2009	131,225

105. Në përfundim të sa më sipër, Komisioni vlerësoi se nuk janë konstatuar problematika lidhur me deklarin e pasurisë në analizë, si dhe me ligjshmërinë e burimeve të krijimit të saj.

REZULTATET SIPAS ANALIZËS FINANCIARE

106. Në vijim të analizës financiare të kryer mbi deklarinet periodike ndër vite, pas përllogaritjeve të kryera në mënyrë të detajuar sipas viteve, lidhur me të gjitha të dhënat mbi të ardhurat, shpenzimet, kursimet, detyrimet dhe nga përllogaritja krahasimore mund të vlerësohet dhe konkludohet mbi mjaftueshmërinë e burimeve financiare për çdo vit, për të përballuar investimet, shpenzimet apo kursimet e deklaruara dhe/ose të konstatuara, me të ardhura nga burime të ligjshme, në kuptimin e nenit D të Aneksit të Kushtetutës.
107. Në këtë analizë janë konsideruar dhe përpunuar të dhënat për pasuritë e realizuara nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, të pasqyruar në vitin e kryerjes së investimit me vlerën e përcaktuar në dokumentacionin e përfitimit, të gjitha të ardhurat e deklaruara ndër vite dhe të ardhurat e dokumentuara, bazuar në përgjigjet e institucioneve dhe dokumentacionit të paraqitur nga subjekti, i bashkëngjitur deklaratës *Vetting* dhe në përgjigje të pyetësorëve, gjendja e likuiditeteve, shpenzimet jetike, si dhe shpenzimet e arsimimit të djalit të subjektit të rivlerësimit.
108. Shpenzimet e arsimimit të djalit të subjektit janë përllogaritur bazuar në vërtetimet e paraqitura mbi kostot e shkollimit, bursave të fituara, si dhe informacioneve të publikuara në faqet zyrtare të universiteteve përkatëse në Austri⁶⁵ dhe në SHBA⁶⁶. Lidhur me shpenzimet e jetesës në këto dy shtete, Komisioni ka zbritur pjesën takuese të qëndrimit (si % në masën totale të shpenzimeve), duke konsideruar vlerën e paguar, konkretisht, nga djali i subjektit për qëndrimin në konvikt në Austri apo qiranë mujore në SHBA.
109. Në vijim, në këtë analizë janë konsideruar dhe përpunuar të dhënat duke filluar nga viti 2003, vit në të cilin fillon edhe deklarimi i pasurisë nga ana e subjektit pranë ILDKPKI-së, nga ku rezultoi një bilanc i përgjithshëm negativ në masën -499.514 lekë.
110. Nga sa më sipër, Komisioni, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe paragrafin 5 të nenit Ç të Aneksit të Kushtetutës, i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës për të dhënë shpjegime

⁶⁵<https://studyinaustria.at/en/living/living-costs>; https://ec.europa.eu/eurostat/databrowser/view/ilc_li01/default/table?lang=en; <https://www.fhwn.ac.at/en/information-for/prospective-students/costs>

⁶⁶<https://www2.census.gov/programs-surveys/cps/techdocs/cpsmar19.pdf>; https://www.arkansasedc.com/docs/default-source/default-document-library/cost-of-living-index-annual-average-2021.pdf?sfvrsn=480cac38_8

bindëse, si dhe për të paraqitur dokumentacionin ligjor për të provuar të kundërtën e rezultateve të Komisionit, lidhur me të gjitha problematikat e konstatuara për kriterin e pasurisë.

Analiza financiare për periudhën 2003 – 2016

Viti	Deri 2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
PASURI	7,792,076	878,577	2,509,029	-400,964	432,353	226,067	587,106	634,587	276,106	5,185,389	-2,607,458	2,851,711	611,440	15,998
Apartament në ***, Tiranë	5,000,000													
Dyqan 103 m2 në Gjirokastër	123,500													
Dyqan 44 m2 në Gjirokastër			383,200	654,515			300,000							
Truall 67 m2 në Gjirokastër														
Apartament 65 m2, në Durrës			2,450,800											
Automjet Ford Focus							850,000							
Investim në shoqërië "****" sh.p.k.									1,000,000					
Apartament në pronësi të djalit													5,506,000	
Gjendje cash ne banese	2,500,000													
Ndryshim likuiditeti	168,576	878,577	-324,971	-1,055,479	432,353	226,067	-562,894	634,587	-723,894	5,185,389	-2,607,458	2,851,711	-4,894,560	15,998
TOTAL LIKUIDITETE DEKLARUAR	168,576	1,047,153	722,182	-333,297	99,056	325,123	-237,771	396,816	-327,078	4,858,311	2,250,854	5,102,564	208,004	224,002
DETYRIME	4,025,647	-285,177	-285,177	-285,177	-285,177	-285,177	-251,839	-332,601	606,214	-587,399	-3,130,644	1,915,804	1,418,948	-479,530
Kredi pranë Bankës së Kursimeve	4,025,647	-285,177	-285,177	-285,177	-285,177	-285,177	-285,177	-285,177	-285,177	-285,177	-285,177	-285,177	-285,177	-285,177
Kredi pranë Raiffeisen Bank							33,338	-47,424						
Kredi në Credins Bank									891,390	-302,222	-345,467	-299,020	-295,876	-194,354
Marrë hua E. Sh.													2,000,000	
Dhënë hua A. H.											-2,500,000	2,500,000		
PASURI NETO	3,766,429	1,163,753	2,794,205	-115,787	717,530	511,243	838,945	967,188	-330,107	5,772,788	523,186	935,907	-807,508	495,528
Të ARDHURA dokumentuar	6,806,592	2,393,989	2,623,362	2,653,276	2,638,649	2,735,327	2,858,806	2,880,295	2,779,917	8,246,764	3,632,231	3,362,396	3,029,968	3,174,702
Te ardhura nga paga e subjektit	4,885,420	1,590,794	1,635,315	1,631,462	1,715,221	1,807,319	1,836,762	1,953,748	1,778,870	1,774,346	1,702,255	1,700,497	1,908,760	1,644,704
Te ardhura nga qiradhenia														
Te ardhura nga interesat bankare											314,543	91,800	8,802	
Te ardhura nga paga e bashkeshortes	1,921,172	803,195	988,047	1,021,814	923,428	928,008	1,022,044	926,547	956,851	939,627	1,054,328	1,058,500	1,112,406	1,085,602
Te ardhura nga paga e djalit	-	-	-	-	-	-	-	-	44,196	532,791	561,105	511,599	-	444,397
Te ardhura nga shitja e njesise										5,000,000				
SHPENZIME	1,900,563	565,332	328,671	600,419	515,211	509,860	947,445	1,317,238	525,538	671,746	1,846,854	1,397,822	2,207,293	2,448,687
Shpenzime jetese	1,335,563	281,592	328,671	328,671	369,266	409,860	409,860	409,860	409,860	423,072	423,072	586,661	504,621	489,775
Shpenzime për blerje aparat fotografik							57,490							
Shpenzime për legalizim objekti								726,925						
Shpenzime arsimimi të djalit	315,000											619,041	1,473,939	1,684,444
Shpenzime udhëtimit		283,740	0	71,748	45,946	0	480,095	180,453	115,678	248,674	423,782	192,120	228,733	274,468
Shpenzime mobilimi	250,000			200,000	100,000	100,000								
Shpenzime te ndryshme											1,000,000			
Analiza dokumentuar	1,139,600	664,904	-499,514	2,168,644	1,405,908	1,714,224	1,072,416	595,869	2,584,487	1,802,230	1,262,191	1,028,667	1,630,183	230,487
DIFERENCA E PA MBULUAR			-499,514											

111. Komisioni çmon se lidhur me analizën financiare për gjithë periudhën e rivlerësimit, ndonëse është konstatuar një pamjaftueshmëri financiare minimale prej 499.514 lekësh – bazuar në parimin e proporcionalitetit dhe objektivitetit – ajo vlerësohet e pamjaftueshme që të passjellë pasoja për subjektin e rivlerësimit.

B. KONTROLI I FIGURËS

112. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit. Për këtë qëllim, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, është përcjellë pranë Komisionit raporti nr. *** prot., datë 27.10.2017, për subjektin e rivlerësimit, me të cilin ishte konstatuar përshtatshmëria e subjektit të rivlerësimit Kasem Berberi për vijimin e detyrës.

113. Me shkresën nr. *** prot., datë 22.4.2022, në përgjigje të kërkesës së Komisionit, DSIK-ja ka bërë me dije se është evidentuar një kontakt i subjektit me një person të dyshuar si i përfshirë në korrupsion dhe shpërdorim detyre, i cili mund të përbëjë një kontakt të papërshtatshëm.
114. Nisur nga sa më sipër, Komisioni iu drejtua Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar⁶⁷, e cila me shkresën kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 16.11.2022, ka bërë me dije se nuk rezultoi që në emër të shtetasit⁶⁸ (i dyshuar si kontakt i papërshtatshëm) të jetë regjistruar ndonjë procedim penal.
115. Gjithashtu, Komisioni iu drejtua edhe Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë⁶⁹, e cila me shkresën kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 24.11.2022, informoi se: *“Nga verifikimet e kryera në indeksat e kallëzimeve dhe statistikave të procedimeve penale për periudhën kohore 2002 – 2022, rezultoi se pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë është regjistruar procedimi penal nr. *** i vitit 2022, i ardhur për kompetencë hetimi nga Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar. Në vendimin për shpalljen e kompetencës shprehet se kanë lindur dyshime se mund të jenë konsumuar elementet e veprave penale ‘falsifikim i dokumenteve’ dhe ‘shpërdorim detyre’, të parashikuara nga nenet 186 dhe 248 të Kodit Penal nga disa persona të punësuar pranë Bordit të Mbikëqyrjes dhe Komisionit të Provimeve të Aftësive Profesionale. Ndërmjet këtyre personave përmendet edhe emri i shtetasit D. N. F., me detyrë kryetar i Bordit të Mbikëqyrjes Publike. Për shtetasin D. N. F. nuk rezultoi të ketë emër të regjistruar në regjistrin e veprave penale si person ndaj të cilit zhvillohen hetimet”*.
116. Më pas, me shkresën e datës 9.8.2022, DSIK-ja ka përcjellë pranë Komisionit raportin e rishikuar nr. *** .., nëpërmjet të cilit ka konfirmuar përshtatshmërinë e subjektit të rivlerësimit Kasem Berberi për vijimin e detyrës.
117. Ndërsa me shkresën e datës 25.10.2022, DSIK-ja i ka komunikuar Komisionit se raporti i sipërcituar është deklasifikuar plotësisht/pjesërisht më 14.10.2022, me vendimin nr. *** të KDZH-së.
118. Përgjatë hetimit administrativ, lidhur me një informacion të klasifikuar, të njohur dhe administruar nga Komisioni, subjekti është pyetur - për aq sa ishte e mundur (në respektim të ruajtjes së konfidencialitetit dhe të dhënave të klasifikuara) dhe e mjaftueshme për qartësimin e situatës objekt vlerësimi. Subjekti ka paraqitur shpjegimet përkatëse, të cilat, pas verifikimeve të kryera, kanë rezultuar të bazuara dhe bindëse lidhur me dinamikën e fakteve dhe marrëdhënien familjare me një person. Gjithashtu, përpos ekzistencës së marrëdhënies familjare, nga hetimet e kryera nga Komisioni, rezultoi edhe mungesa e elementeve faktiko-ligjore të nevojshme për cilësimin e një personi të dyshuar si një kontakt i papërshtatshëm. Kësisoj, u shterua çdo dyshim lidhur me ndonjë kontakt të papërshtatshëm të subjektit me persona të përfshirë në krimin e organizuar.

⁶⁷ Shkresë nr. *** prot., datë 10.11.2022.

⁶⁸ Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar nga Komisioni, si dhe nga analizimi i të dhënave të disponueshme nga Zyra e Gjendjes Civile ka rezultuar se ky shtetas (i dyshuar si kontakt i papërshtatshëm) është nipi i subjektit, konkretisht djali i motrës së tij.

⁶⁹ Shkresë nr. *** prot., datë 11.11.2022.

119. Në këto kushte, në përfundim të rivlerësimit për kriterin e kontrollit të figurës, Komisioni konstaton se subjekti i rivlerësimit Kasem Berberi arrin nivel të besueshëm në kontrollin e figurës sipas parashikimit të nenit 59/1, germa “b” e ligjit nr. 84/2016, për sa kohë nga verifikimet e kryera: (i) nuk rezultoi se ai ka pasur apo të ketë aktualisht kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar; (ii) ka dorëzuar në kohë deklaratën për kontrollin e figurës; si dhe (iii) nuk ka bërë deklarime të pasakta, të paplota dhe nuk ka fshehur të dhëna apo kontakte me persona të përfshirë në krimin e organizuar.

C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

C/1. RIVLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE NGA KLP-ja

120. Komisioni, në bazë të neneve 40 - 44 të ligjit nr. 84/2016, pasi ka administruar dhe analizuar raportin e KLP-së, si dhe dokumentacionin e bashkëngjitur, ka kryer rivlerësimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit Kasem Berberi në përputhje me nenin E të Aneksit të Kushtetutës.
121. Rivlerësimi i aftësive profesionale është mbështetur në: (a) raportin për analizimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, të kryer dhe të përcjellë në Komision; (b) informacionin e marrë nga burime të ligjshme, si i tillë është konsideruar informacioni i marrë nga denoncimet dhe organet ligjzbatuese – burime të cilat, kur ka qenë nevoja, i janë nënshtruar verifikimit të vërtetësisë së tyre nga Komisioni; (c) kriteret e vlerësimit të parashikuara në nenin 71 e vijues të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.
122. Raporti nr. ***, datë 16.11.2021, i përcjellë nga KLP-ja, është kontrolluar në drejtim të saktësisë dhe të standardizimit të tij, raport i cili ka të dhënat e rezultuara nga dokumentet, duke iu referuar kriterëve të vlerësimit, si: (i) aftësive profesionale; (ii) aftësive organizative; (iii) etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale; (iv) aftësive personale dhe angazhimit profesional.
123. Duke iu referuar të dhënave të deklaruara në formular, si dhe të dhënave në arkivin e drejtorisë ekonomike dhe burimeve njerëzore në Këshillin e Lartë të Prokurorisë, konstatohet se subjekti i rivlerësimit Kasem Berberi për periudhën korrik 1999 – janar e në vijim ka ushtruar funksionin e prokurorit në Prokurorinë e Përgjithshme Tiranë (në drejtorinë e hetimit). Për periudhën janar 2015 e në vazhdim ushtron funksionin e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.
124. Subjekti i rivlerësimit Kasem Berberi ka deklaruar se gjatë tri viteve të fundit ka ushtruar funksionin e prokurorit pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë në fushën e të drejtës penale materiale dhe procedurale. Për sa i përket të dhënave statistikore, prokurori Kasem Berberi ka deklaruar se gjatë vitit 2014 ka ushtruar funksionin e prokurorit në Prokurorinë e Përgjithshme në drejtorinë e hetimit. Gjatë kësaj periudhe ka ndjekur ankesa të ndryshme të qytetarëve apo institucioneve, në varësi të urdhrave dhe porosive të Prokurorit të Përgjithshëm dhe drejtorit përkatës.
125. Nga verifikimi në sektorin e burimeve njerëzore pranë Prokurorisë së Përgjithshme rezultoi se për periudhën e rivlerësimit tetor 2013 – tetor 2016, për subjektin e rivlerësimit, prokurorin Kasem Berberi, nuk është marrë asnjë masë disiplinore. Nga vlerësimet e punës së subjektit për

vitet 2014, 2015 dhe 2016, të bëra nga Prokurori i Përgjithshëm, rezulton se: për vitin 2014 subjekti nuk ka vlerësim pune; për vitin 2015 subjekti është vlerësuar “mirë” për etikën profesionale të treguar prej tij; për vitin 2016 subjekti është vlerësuar “shumë mirë” për etikën profesionale të treguar prej tij.

126. Nga verifikimi i të dhënave nga burimet arkivore në Prokurorinë e Përgjithshme dhe Këshillin e Lartë të Prokurorisë rezultoi se për subjektin e rivlerësimit Kasem Berberi janë regjistruar 3 ankesa⁷⁰, të cilat janë trajtuar duke u kthyer përgjigje ankuesve dhe se ndaj subjektit të rivlerësimit janë regjistruar dy kallëzime⁷¹ në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, kallëzime për të cilat është marrë vendim për mosfillimin e tyre nga kjo Prokurori.
127. Nga tri dokumentet ligjore të paraqitura nga vetë subjekti dhe nga pesë dosjet e vëzhguara nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit. Në asnjë prej pesë dosjeve të vëzhguara nuk ka të dhëna mbi ndonjë shkak të dokumentuar, ku të ketë cenuar të drejtat e palëve dhe të viktimave.
128. Komisioni, pasi u njoh dhe analizoi dokumentacionin e depozituar nga KLP-ja, mbi të cilin është hartuar raporti i vlerësimit profesional për këtë subjekt rivlerësimi, për sa i përket tri dokumenteve të vëna në dispozicion nga subjekti, por edhe atyre të administruara mbi bazë shorti, përgjithësisht nuk vërejtí problematika të natyrës procedurale dhe as mangësi profesionale apo cilësi që cenojnë figurën e prokurorit. Ndërsa lidhur me dy dosjet e shortuara i kërkoi subjektit të japë shpjegime mbi mosrespektimin e afatit të hetimeve.
129. Konkretisht për dosjen nr. 2, që i përket kallëzimit penal nr. ***, datë regjistrimi 7.12.2015, nga ku Komisionit i rezultoi se vendimi i mosfillimit të procedimit penal është marrë jashtë afatit 30-ditor të parashikuar në udhëzimin nr. ****, datë 19.6.2012 “Për një ndryshim dhe një shtesë në udhëzimin nr. ***, datë 21.11.2005 ‘Për regjistrimin e njoftimit të veprës penale dhe të emrit të personit që i atribuohet vepra penale’”, i ndryshuar i Prokurorit të Përgjithshëm.
130. Në prapësimet e dërguara, subjekti ka sqaruar se pas regjistrimit të kallëzimit penal më 7.12.2015, materiali është marrë më 15.12.2015 dhe i ka kaluar për veprime oficerit të policisë gjyqësore. Për t’i dhënë zgjidhje është dashur të pritët aktekspertimi toksikologjik dhe të pyetëj shtetasja që ndodhej e shtruar në ambientet e spitalit, pasi kishte tentuar të helmohej. “*Këto kanë qenë shkaqet dhe arsyet që kanë bërë të mundur mosrespektimin e afatit 1-mujor të përcaktuar në udhëzimin nr. ***, datë 19.6.2012*”, është shprehur subjekti i rivlerësimit.
131. Në shpjegimet e dërguara lidhur me dosjen nr. 3, që i përket procedimit penal nr. ***, regjistruar në datën 14.6.2015, për veprën penale “shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor”, lidhur me mosrespektimin e afatit ligjor, subjekti shpjegoi se vonesa ka ardhur si pasojë e ngarkesës së lartë në punë dhe për shkak të pritjes së aktekspertimit autoteknik të aksidentit, duke qenë këto arsye e mosrespektimit të afateve procedurale.

⁷⁰ Praktika nr. ***, datë 13.6.2016; praktika nr. ***, datë 19.12.2017; praktika nr. ***, datë 19.9.2017.

⁷¹ Kallëzimi penal nr. ***, datë 24.10.2019 dhe kallëzimi penal nr. ***, datë 29.12.2017.

Vlerësimi i trupit gjykues

132. Komisioni, pasi vlerësoi prapësimet e subjektit në lidhje me dy dosjet e shortuara, çmon se mosrespektimi i afatit 30-ditor në vendimmarrjen për mosfillimin e procedimit penal ka qenë i kushtëzuar nga vonesa e shkaktuar nga administrimi i aktekspertimeve, shkak ky i pavarur nga subjekti i rivlerësimit.
133. Në përfundim, trupi gjykues ka konstatuar se shpjegimet e subjektit kanë qenë shteruese, për aq kohë sa nuk rezulton që të ketë kryer shkelje ligjore në aspektin procedural përgjatë hetimeve të këtyre çështjeve.

C/2. RIVLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE NGA KOMISIONI

134. Komisioni, në bazë të neneve 40 - 44 të ligjit nr. 84/2016, pasi ka analizuar raportin e KLP-së, si dhe dokumentacionin e bashkëngjitur, ka kryer rivlerësimin e aftësive profesionale në përputhje me nenin E të Aneksit të Kushtetutës, duke shqyrtuar edhe informacionet e marra nga denoncimet publike, të administruara për këtë qëllim.

DENONCIME NGA PUBLIKU

135. Pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit janë paraqitur nga publiku 8 denoncime, të cilat janë shqyrtuar së bashku me materialet përkatëse. Në vijim të denoncimeve, bazuar në nenin 53 të ligjit nr. 84/2016, janë administruar disa akte/dosje hetimore dhe gjyqësore, për të vlerësuar aspektin profesional të subjektit të rivlerësimit. Komisioni, pasi ka shqyrtuar denoncimet që janë paraqitur nga publiku pranë këtij institucioni, ka konstatuar sa vijon.
136. **Denoncim nr. *** prot., datë 18.1.2019, i shtetasit I. Th.**

Shtetasi pretendon se prokurori ka kryer shkelje ligjore, pasi, në kundërshtim me ligjin, nuk e ka dërguar çështjen në gjykatë, por ka vendosur pushimin, me arsyetimin se ndodhet përpara “gjësë së gjykuar”, vendim që është ankimuar. Komisioni⁷² iu drejtua Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë⁷³ dhe kjo e fundit vuri në dispozicion kërkesën për pushimin e procedimit penal nr. ***, viti 2018. Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezultoi se procedimi ishte regjistruar për herë të dytë po për të njëjtin fakt si në vitin 2015, kallëzimi nr. ***, për të cilin organi i Prokurorisë ishte shprehur me vendim më parë, vendim që nuk ishte shfuqizuar as nga Gjykata dhe as nga prokurori më i lartë. Pra, efektivisht kjo situatë juridike gjendej përpara parimit të “gjësë së gjykuar” dhe ishte shkak ligjor ku ishte mbështetur prokurori për vendimin e pushimit të hetimeve për procedimin penal nr. ***, viti 2017. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. *** regj., datë 11.2.2021, pranoi kërkesën e prokurorit, vendim që është lënë në fuqi edhe nga Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin nr. ***, datë 4.10.2021. Në këto kushte, Komisioni nuk vlerësoi shkaqe për thellimin e denoncimit, për sa kohë nuk evidentohet asnjë rrethanë e dyshimtë për ndonjë përgjegjësi të subjektit.

⁷² Shkresë nr. **** prot., datë 24.10.2022.

⁷³ Shkresë nr. *** prot., datë 2.11.2022.

137. **Denoncim nr. *** prot., datë 11.1.2018, i shtetas V. D.**

Shtetasja denoncon prokurorin për vendimmarrje të gabuar të datës 25.5.2016 për mosfillimin e procedimit penal, që i përket kallëzimit penal nr. ***, viti 2016, vendim me të cilin është njohur edhe vetë denoncuesja. Nuk shihen shkaqe për thellimin e hetimit, pasi nuk parashtrohen shkelje procedurale, por në thelb denoncimi shfaq pakënaqësi lidhur me vendimmarrjen e prokurorit që nuk është objekt shqyrtimi nga Komisioni.

138. **Denoncim nr. **** prot., datë 31.3.2022, i shtetasit I. C.**

Denoncuesi nuk përshkruan shkelje procedurale nga prokurori, por shfaq pakënaqësi lidhur me vendimmarrjen e tij e, në këto kushte, Komisioni iu drejtua Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë⁷⁴ për vënien në dispozicion të procedimit penal nr. ***, viti 2019, për veprën penale “falsifikim i dokumenteve”. Në përfundim të hetimeve është vendosur pushimi i çështjes, bazuar në Kodin Penal, neni 189, pasi kishin kaluar afatet e parashkrimit të ndjekjes penale⁷⁵ për këtë vepër penale. Duke arsyetuar veç të tjerash se, edhe nëse merret e mirëqenë se është konsumuar vepra penale “falsifikim i dokumenteve” nga shtetasja F. C. dhe nga “R. Bank” tashmë, kishin kanë kaluar mbi 10 vjet nga shkelja procedurale⁷⁶, duke bërë kështu të pamundur fillimin e ndjekjes penale. Vendimi i është komunikuar edhe denoncuesit. Nga Komisioni nuk evidentohen shkaqe për thellimin e hetimit, për sa kohë nuk përshkruhen shkelje ligjore apo procedurale nga denoncuesi, por pretendimet kanë të bëjnë kryesisht me vendimmarrjen e prokurorit, që nuk është objekt shqyrtimi nga Komisioni.

139. **Denoncim nr. ***, datë 25.4.2018, i shtetasit F. A.**

Familjarët e të ndjerit D. A. në denoncimin e bërë kanë ngritur pretendim mbi mënyrën e hetimit dhe gjykimit të çështjes së të ndjerit – djalit të tyre – i cili humbi jetën gjatë operacionit estetik në qepallat e syve në ***.

Rrethanat e faktit – familjarët e viktimës kanë ngritur një kallëzim kundër ***-së dhe çështja është ndjekur nga prokurori Kasem Berberi, i cili me vendimin nr. ***, datë 16.11.2015, ka vendosur mosfillimin e hetimeve, vendim që është ankimuar nga pala. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. ***, datë 25.4.2016, urdhëroi organin e Prokurorisë për vijimin e hetimeve, duke vlerësuar se: *“Gjatë administrimit të dokumentacionit nga organi i prokurorisë janë konstatuar disa akte të panënshkruara dhe të paadministruara sipas parashikimeve të Kodit të Procedurës Penale. Po ashtu, organi i Prokurorisë gjatë hetimit nuk i ka dhënë përgjigje disa pretendimeve të kallëzuesve, të cilat janë kërkuar të hetohen nga kallëzuesit. Ndërsa, për sa i përket pretendimit të organit të Prokurorisë se ndodhemi përpara ‘gjësë së gjykuar’, gjykata po ashtu ka vlerësuar se në dosje nuk ka asnjë akt që të provojë këtë pretendim, duke vlerësuar se organi i Prokurorisë nuk mund të marrë vendimin për mosfillimin, pa marrë minimumin e të dhënave në lidhje me çështjen që kallëzohet”*, vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë rezulton të mos jetë ankimuar.

⁷⁴ Shkresë nr. *** prot., datë 11.10.2022.

⁷⁵ Neni 66 i Kodit Penal.

⁷⁶ Kontrata e kredisë në vitet 2006 dhe 2008.

Pas regjistrimit të veprës penale nr. ***, viti 2017, prokurori administroi aktet e marrëveshjes dypalëshe⁷⁷, që ndodheshin në fashikullin e dosjes tjetër penale, asaj me nr. ***, viti 2015. Nga organi i akuzës në përfundim të hetimeve dhe kryerjes së veprimeve të urdhëruara nga gjykata vendosi “pushimin e procedimit penal nr. ***, viti 2017”, vendim që u la në fuqi nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë me vendimin nr. *** regj. themeli., datë 9.11.2017. Vendimi u ankimua nga familjarët e viktimës dhe Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin nr. ***, datë 31.1.2018⁷⁸, vlerësoi se organi i akuzës tashmë kishte kryer veprime të plota të gjithanshme e objektive, duke verifikuar dhe u dhënë përgjigje të gjitha pretendimeve të palës kallëzuese/denoncuese.

Për sa më lart, nga ana e Komisionit nuk u evidentuan shkaqe për thellimin e hetimit për aq kohë sa pretendimet e ngritura si pjesë e denoncimit ishin shqyrtuar si pjesë e ankimit me vendim nga Gjykata e Apelit Tiranë, duke e konsideruar të drejtë vendimin e pushimit të marrë nga subjekti i rivlerësimit.

Nga sa u përshkrua më sipër, Komisioni ftoi subjektin e rivlerësimit të japë shpjegime lidhur me marrjen e vendimit të mosfillimit të hetimeve, pa kryer më parë të gjitha veprimet verifikuese apo hetimore (konkretisht mosadministrimin, në formën e kërkuar nga ligji, të dokumentacionit dhe akteve nga dosja tjetër penale), nëpërmjet të cilave do të mund të provohej se çështja në fjalë përbënte “gjë të gjykuar” – siç ishte pretenduar nga organi i akuzës.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

140. Në prapësimet e dërguara, subjekti i rivlerësimit shpjegoi se në vendimmarrjen për mosfillimin e procedimit penal kishte vlerësuar se aktet e administruara gjatë fazës së verifikimit të kallëzimit penal kanë qenë të mjaftueshme për të marrë vendimin. Ndërsa, lidhur me mosadministrimin e dokumentacionit në fashikullin tjetër, jo në formën e duhur ligjore, të akteve të pafirmosura, subjekti shpjegoi se kjo ka ardhur si pasojë e printimit të akteve nga sistemi elektronik (i besueshëm si burim zyrtar) dhe vendimit të gjykatës nga sistemi *online* i faqes zyrtare të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.
141. Trupi gjykues vlerëson se përpos mungesës së formalitetit në mënyrën e administrimit të akteve në fjalë vlerësimi i kryer nga subjekti është bazuar mbi akte të besueshme dhe se në substancë nuk do të ndryshonte asgjë, edhe nëse ato do të ishin administruar nëpërmjet burokracisë institucionale – sikurse realisht nuk ka ndryshuar asgjë, edhe pas administrimit zyrtar të këtyre akteve lidhur me përmbajtjen e këtyre dokumenteve, si dhe me vlerësimin dhe vendimin final të kësaj shtate. Kësisoj, Komisioni nuk ka gjetur ndonjë shkelje procedurale apo vlerësim aktesh apo faktesh të gabuara, që mund të ngrinin dyshime mbi ndonjë favorizim të mundshëm të palëve të interesuara në çështjen *de quo*.

⁷⁷ Aktmarrëveshje midis ***-së dhe shoqatës “****”.

⁷⁸ Gjykata e Apelit Tiranë ka vlerësuar se nga hetimet e kryera nuk ka rezultuar ndonjë lidhje shkakësore midis veprimtarisë së drejtuesve dhe pasojës së ardhur, pasi sikurse është relatuar në vendim, mjeku përgjegjës është dënua me një vendim penal aktualisht të formës së prerë.

142. **Denoncim nr. *** prot., datë 1.6.2018, i shtetasit S. T.**

Shtetasi denoncon prokurorin dhe një gjyqtar⁷⁹, duke pretenduar se janë kryer shkelje të natyrës procedurale në dhënien e vendimit, se prokurori i ka bërë denoncuesit presion psikologjik dhe e ka detyruar të firmosë në procesverbal dhe se kallëzuesja nuk ka pasur prova të mjaftueshme për të provuar ekzistencën e dhunës ndaj saj.

Nga shqyrtimi i materialit të administruar nga Komisioni rezultoi se denoncuesi (S. T.) është dënuar për veprën penale “dhunë në familje” nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë me vendimin nr. ***, datë 23.5.2016. Në pretendimet e ngritura që janë të njëjta me ato të parashtruara në denoncimin në analizë, rezulton se ato janë vlerësuar, sqaruar dhe u është dhënë përgjigje e argumentim ligjor nga vendimi i gjykatës.

Për sa i takon refuzimit për nënshkrimin e disa akteve të fashikullit penal, Komisionit i rezultoi si provë në dosjen gjyqësore akti mjekoligjor i datës 23.2.2015, që provonte se dëmtimet e konstatuara të kallëzuesja ishin shkaktuar me mjete të forta mprehëse dhe se procesverbali i datës 29.6.2015 për marrjen në pyetje të shtetasit S. T. ishte i firmosur prej tij, nga ku nuk evidentohet ndonjë shënim. Lidhur me vendimin e datës 30.9.2015 për marrjen të pandehur dhe njoftimin e akuzës denoncuesit, shtetasi rezulton të ketë refuzuar marrjen e njoftimit.

Për sa më lart, duke qenë se pretendimeve të denoncuesit u është dhënë zgjidhje gjatë gjykimit, vlerësohet se këto pretendime ngrihen në kuadrin e vendimmarrjes nga gjykata, që nuk është objekt i vlerësimit nga ky Komision.

143. **Denoncim nr. *** prot., datë 4.2.2021, i shtetasit L. N.**

Denoncuesi pretendon se prokurori ka tejzgjatur hetimet për më shumë se 1 vit dhe në përfundim ka vlerësuar se çështja nr. ***, viti 2020, për veprën penale “mashttrim” duhet të pushohet, me arsyetimin se shkak i gjendjes së krijuar⁸⁰ nuk ka qenë shoqëria, por vetë denoncuesi, duke pretenduar për favorizim të ndërtuesit nga prokurori. Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me shkresën nr. *** prot., datë 2.11.2022, vuri në dispozicion kërkesën për pushimin e çështjes penale nr. ***, viti 2020, drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, vendim i cili u është komunikuar edhe palëve. Nga shqyrtimi i praktikës referuar shkakut për të cilin ngrihet ky denoncim, rezultoi se çështja është regjistruar më 19.2.2020, por pa autor, dhe se vendimi për pushimin e çështjes penale është marrë më 28.12.2020, pra në tejkalim të afatit të parashikuar nga neni 323 i Kodit të Procedurës Penale. Komisioni ka ftuar subjektin të japë shpjegime lidhur me përfundimin e hetimeve tej afatit ligjor të parashikuar.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

144. Subjekti i rivlerësimit në prapësimet e depozituara ka sqaruar se tejkalimi i afateve për këtë çështje penale ka ardhur si shkak i pezullimit të punës për efekt të pandemisë Covid-19. Komisioni i gjeti bindëse shpjegimet e subjektit, për sa kohë gjendet në një kontekst jo të zakonshëm.

⁷⁹ Gjyqtar A. M.

⁸⁰ Për ekzekutimin e apartamentit të ndërtuar nga shoqëria “****”.

145. **Denoncim nr. *** prot., datë 20.12.2017, i shtetases A. L.**⁸¹

Ky denoncim është marrë në shqyrtim edhe në kapitullin “Të dhëna nga burime arkivore” nga KLP-ja, po ashtu për sa i përket pretendimeve të ngritura në kallëzimin e paraqitur prej saj ndaj subjektit të rivlerësimit rezultoi se nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Durrës më 18.1.2018 është vendosur *mosfillimi i procedimit* penal nr. ***, bazuar në nenin 290, germa “ç” dhe neni 291 të Kodit të Procedurës Penale. Në këtë vendim është arsyetuar se kërkesat e kallëzueses kanë të bëjnë me fakte të shqyrtuara gjatë një procesi hetimor penal, të cilat janë analizuar nga prokurori në funksion të hetimeve paraprake, duke vendosur në paanësi, në përputhje me ndërgjegjen dhe interpretimin ligjor për faktet dhe në zbatim të normave të së drejtës, të sanksionuar në Kodin e Procedurës Penale. Për rrjedhojë, nuk shihen *indicie* për thellimin e hetimit, për sa kohë pretendimet e paraqitura nga denoncuesja janë vlerësuar edhe më herët⁸² dhe lidhur me to është marrë vendimi për mosfillimin e hetimit nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.

146. **Denoncim nr. *** prot., datë 14.12.2017, i shtetases M. D.**

Shtetasja ka denoncuar tre prokurorë e ndërmjet tyre edhe prokurorin Kasem Berberi, ndonëse nuk ka përshkruar ndonjë pretendim specifik apo *indicie* për shkelje procedurale prej tij. Nga vlerësimi i dokumentacionit të administruar rezultoi se prokurori ka vendosur *mosfillimin e procedimit penal* lidhur me kallëzimin nr. ***, viti 2016. Duke qenë se ky denoncim është marrë në vlerësim edhe më parë nga Komisioni, nga shqyrtimi i materialit të administruar u konstatua se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka urdhëruar vazhdimin e hetimeve të procedimit penal të vitit 2016 – por jo lidhur me kallëzimin penal nr. ***, viti 2016 – të ndjekur nga prokurori Kasem Berberi. Në përfundim, Komisioni vlerëson se nuk u gjenden shkaqe për thellimin e këtij hetimi, pasi edhe nga vetë denoncuesja nuk janë përshkruar shkelje procedurale të subjektit të rivlerësimit.

147. **Denoncim nr. *** prot., datë 9.3.2023, i shtetasit I. C.**

Shtetasi denoncon subjektin e rivlerësimit lidhur me procedimin penal nr. ***, datë 8.2.2021, i hetuar dhe i pushuar prej tij, regjistruar për veprat penale “falsifikim” dhe “vjedhje me anë të mashtrimit” ndaj shtetases R. K.. Komisioni i kërkoi subjektit të rivlerësimit⁸³ shpjegime shteruese lidhur me shkaqet e moskryerjes së hetimeve, lidhjes që kishte ky procedim me objektin e procedimit penal nr. ***, ecurinë e mëtejshme të procedimit të hetuar, duke i kërkuar të paraqiste vendimin e Gjykatës që ka pranuar kërkesën për pushimin e procedimit penal.

Subjekti i rivlerësimit⁸⁴ paraqiti shpjegime dhe dokumentacion përmbledhës mbi këtë ankesë, duke sqaruar se pas regjistrimit të kallëzimit penal nr. ***, të depozituar nga shtetasi dhe pas regjistrimit të procedimit janë kryer verifikimet përkatëse në regjistrin e procedimeve penale, nga ku rezultoi se në regjistrin e procedimeve penale është regjistruar procedimi nr. ***, datë 30.7.2019, për veprat penale “shpërdorim i detyrës” dhe “mashtrim”, parashikuar nga nenet 248 dhe 143 të Kodit Penal. Gjithashtu, më 5.11.2019, është regjistruar edhe procedimi penal nr. ***,

⁸¹ Trajtuar në rubrikën “Të dhëna nga burime arkivore” nga KLP-ja, praktika nr. *** prot., datë 19.12.2017.

⁸² Vendim nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Durrës më 18.1.2018.

⁸³ Nëpërmjet postës elektronike, datë 9.2.2023.

⁸⁴ Nëpërmjet postës elektronike datë 10.3.2023.

me kallëzues shtetasin U. P., me vendimin e datës 5.11.2019 është vendosur bashkimi i procedimeve të procedimeve të mësipërme në një procedim penal të vetëm, me nr. ***, viti 2019.

Në këto rrethana, me procesverbalin e datës 27.7.2021, u administruan si pjesë të fashikullit të procedimit penal nr. ***, viti 2021, fotokopje të akteve të fashikullit të procedimit penal nr. ***, viti 2019, gjithsej tri volume, si edhe fotokopje e vendimit nr. *** regj. them., datë 9.7.2021, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Nga studimi i akteve të procedimit penal nr. ***, viti 2019, rezultoi se në përfundim të hetimeve paraprake më 5.3.2020, prokurori paraqiti në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë kërkesën për pushimin e procedimit penal nr. ***, viti 2019.

Pas shqyrtimit të kësaj çështjeje, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. *** regj. them., datë 9.7.2021, ka vendosur: *“Pranimin e kërkesës së organit të akuzës për pushimin e procedimit penal nr. ***, viti 2019, për veprat penale ‘shpërdorim detyre’, e parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal dhe ‘mashttrim’, e parashikuar nga neni 143 i Kodit Penal”*. Kundër këtij vendimi është bërë ankim në Gjykatën e Apelit Tiranë, e cila me vendimin nr. *** akti, datë 9.7.2020, ka vendosur: *“Lënien në fuqi të vendimit nr. *** akti, datë 9.7.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë”*.

148. Nga studimi i akteve të procedimit penal nr. ***, viti 2019 rezultoi se fakti objekt hetimi i këtij procedimi penal është i njëjtë me faktin objekt hetimi i procedimit penal nr. ***, viti 2021 – procedime të cilat janë regjistruar mbi bazën e kallëzimit të të njëjtit shtetas, z. I. C. Ndodhur në këto rrethana, kur për të njëjtin fakt është vendosur më parë regjistrimi i procedimit dhe nga organi i Prokurorisë dhe i ishte dhënë një zgjidhje ligjore, njëkohësisht kishte edhe një vendimmarrje nga gjykata, hetimet në kuadër të procedimit penal që ishin regjistruar nuk mund të vazhdonin, pasi ndodhet para parimit të “gjësë së gjykuar”. Në kërkesën e paraqitur në gjykatë janë arsyetuar dhe argumentuar shkaqet ligjore për të cilat kërkohet pushim i procedimit penal. Kërkesa e mësipërme është shqyrtuar nga gjykata dhe është miratuar *pushim i hetimeve për procedimin penal nr. ***, viti 2021*.
149. Nisur nga sa më sipër dhe nga fakti se pretendimeve të subjektit të rivlerësimit u është dhënë përgjigje nga vendimi i Gjykatës, Komisioni nuk ka konstatuar moskryerje të veprimeve hetimore, sikurse pretendohet në denoncim.

KONKLuzion Përfundimtar

150. Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mbledh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, referuar në nenin 4, pika 2, nenin 58, pika 1, germa “a”, si dhe në nenin 59, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit Kasem Berberi:
- a) ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë;
 - b) ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës;
 - c) ka arritur një nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

PËR KËTO ARSYE,

151. Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në nenin 179/b të Kushtetutës, në nenin D të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mbledh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Steven Kessler, në bazë të germës “a” të pikës 1 të nenit 58 dhe të pikave 1 dhe 4 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Kasem Berberi, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë, si dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga Komisioneri Publik dhe/ose subjekti i rivlerësimit 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në datën 17.3.2023.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Valbona SANXHAKTARI
Kryesuese

Lulzim HAMITAJ
Relator

Genta TAFA (BUNGO)
Anëtare

Sekretare gjyqësore
Ertugena Sokoli